



UDHËZUES PRAKTIK

për sfidimin e procedurave
të heqjes dorë nga gjykimi



Fair Trials International

Fair Trials është një OJF ndërkombëtare që promovon sisteme drejtësie penale që janë të drejtë dhe të barabartë

Qendra Res Publica

Res Publica është një OJF që promovon dhe mbrojnë të drejtat e njeriut përmes litigimit, edukimit dhe advokimit



**Funded by
the European Union**

Ky dokument u mundësua falë mbështetjes financiare të Programit të Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk nënkupton se reflekton pikëpamjet e Komisionit Evropian.

Ky publikim është përgatitur në partneritet me Fair Trials International dhe me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Qendrës Res Publica dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton opinionin e Bashkimit Evropian.

Autor:

Av. Theodoros Alexandridis

Botues: Qendra “Res Publica”

Redaktorë: Dr. Irena Dule, Av. Dorian Matlija,

UDHËZUES PRAKTIK

për sfidimin e procedurave
të heqjes dorë nga gjykimi

PERMBAJTJA

5 Hyrje

9 Pjesa A: E drejta e brendshme dhe gjendja aktuale

9 Aksesi në avokat

14 Aksesi në dosjen e çështjes

15 Barazia e armëve në fazën hetimore

19 Pjesa B: Sfidimi i modaliteteve të aplikimit të heqjes dorë nga gjykimi në Shqipëri

19 Përdorimi i të gjitha mjeteve procedurale që vë në dispozicion ligji shqiptar

22 Sjellja e argumenteve, bazuar në ligjin e krahasuar, me synimin për të evidentuar mungesën e masave të duhura mbrojtëse në proceset që zhvillohen me procedurën e gjykimit të shkurtuar sipas ligjit shqiptar

23 Argumentet bazuar në qasjen kufizuese ndaj heqjes dorë nga gjykimi, të miratuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

29 Pjesa C: Rekomandime drejt sigurimit të një marrëveshjeje më të mirë për të gjithë

29 Mbledhja dhe shpërndarja e statistikave më të plota mbi heqjet dorë nga gjykimi

31 Bërja më transparente e gjykimeve me marrëveshje

32 Përfitimi nga praktikat e mira ekzistuese dhe marrja e masave për krijimin e një fushe më të barabartë loje midis të pandehurve / avokatëve të tyre dhe prokurorëve / gjyqtarëve



HYRJE

Jeta në shoqëritë moderne është veçanërisht komplekse dhe kërkon rregullim ligjor, përfshirë ligjin penal, të një numri gjithnjë e më të madh aktivitësh të përditshme. Rritja e konsiderueshme e veprave dhe veprimeve që mund të jenë objekt procedimi penal, së bashku me shfaqjen e formave të reja dhe të komplikuar të kriminalitetit shoqërohet me nevojën për t'i luftuar ato në mënyrë efektive, gjë e cila është kthyer në një sfidë për autoritetet e prokurorisë dhe gjyqësorit të cilat, të mbingarkuara me çështje, u duhet të arrijnë një ekuilibër mes respektimit të garancive të mirë-vendosura të procedurës penale, dhe zgjidhjes së këtyre çështjeve sa më shpejt të jetë e mundur. Si rezultat, dhe çka do të konsiderohej në kundërshti me vetë parimin e drejtësisë, jo shumë kohë më parë, për një numër gjithnjë e më të madh të pandehurish në të gjithë botën çështjet nuk shqyrtohen në gjykatë, por përjashtohen në bazë të një marrëveshjeje mes tyre dhe prokurorit ose gjyqtarit, sipas së cilës të pandehurit bien dakord të heqin dorë nga disa prej të drejtave të tyre procedurale, në këmbim të një gjykimi më të shpejtë dhe uljes së dënimit.

Sipas organizatës kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave penale, Fair

Trials International, praktika të tilla në thelb konsiderohen heqje dorë nga e drejta për një gjykim të plotë. Këto “heqje dorë nga gjykimi” mund dhe të përkufizohen si procese: “... që nuk ndalohen me ligj sipas të cilave të pandehurit penal bien dakord të pranojnë fajësinë dhe / ose të bashkëpunojnë me autoritetin hetues, në këmbim të një përfitimimi nga shteti, më së shpeshti në formën e uljes së numrit të akuzave dhe / ose uljes së dënimeve.”¹

Termi “heqje dorë nga gjykimi” është i përgjithshëm, pasi sisteme të tilla hasen me terma të ndryshëm, duke filluar nga më i njohuri “marrëveshje mbi pranimin e fajësisë” (*plea bargain*) që e hasim tek filmat amerikanë televizivë, deri tek ai më pak i njohur “gjykimi përmbledhës / i shkurtuar” që të paktën, qoftë edhe pse vetëm nga emri, të sjell në mendje një gjykim të duhur. Sidoqoftë, pavarësisht emrit, e përbashkëta e këtyre sistemeve është pikërisht elementi i ujdisë, një negociatë midis një zyrtari të drejtësisë (zakonisht prokurorit) dhe të pandehurit, ku ky i

1 Fair Trials International, “Gjykimi i Zhdukur: Drejt një qasjeje të bazuar në të drejta të sistemeve të heqjes dorë nga gjykimi”, faqe 2.

fundit heq dorë nga një prej të drejtave të tij procedurale penale ose pranon fajësinë në këmbim të rrëzimit të disa prej akuzave ose të zvogëlimit të dënimit.

Arsyeja kryesore e popullaritetit gjithnjë në rritje të sistemeve të heqjes dorë nga gjykimi është pikërisht fakti se, nëse zbatohen siç duhet, të dyja palët përfitojnë. Kështu, prokuroria dhe gjykatat mund të heqin shpejt nga lista e çështjeve të prapambetura, çështje që përndryshe do të impenjonin burime të vlefshme, por të kufizuara policore dhe gjyqësore (madje, në rastet e bashkëpunëtorëve të drejtësisë do u lejonte autoriteteve të kryenin hetime më efektive duke u përbërë incentiv për të pandehurit që të japin informacion inkriminues për bashkëpunëtorët e tyre të mëparshëm), ndërsa të pandehurit mund të dinë paraprakisht se cili do të jetë dënimi i tyre pak a shumë, të përfitojnë nga ulja e dënimit, të shmangin paraburgimin e gjatë dhe të evitojnë kostot e mëdha të një procesi të gjatë gjyqësor. Si rezultat, heqja dorë nga gjykimi paraqitet shumë tërheqëse, si për gjykatat ashtu edhe për të pandehurit, dhe me gjasa pritet të mbetet një element kryesor i pjesës më të madhe, në mos i të gjitha sistemeve juridike.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, nuk mund të mohohet se vetë nocioni i drejtësisë së negociuar, mbi të cilin bazohen mekanizmat e heqjes dorë nga gjykimi, duket se bie ndesh me konceptet tradicionale për mënyrën si gjykatat duhet të administrojnë drejtësinë; në fund të fundit është e pritshme që fajtorët të përgjigjen plotësisht për krimet e tyre, jo të bëjnë marrëveshje me prokurorët për të siguruar dënime më të ulëta. Është e vështirë të mos pajtohesh me vëzhgimin e Gjyqtarit të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara, Kennedy, në lidhje me faktin se sistemi i sotëm i drejtësisë penale (në SHBA), ku deklaratat e fajësisë përbënin 95% të të gjitha dënimeve penale në 2009, nuk bazohet në gjykime, por mbi pranime

fajësie të detyruara në mënyrë indirekte. Për të ky fenomen është si një “*tregti kuajsh*” midis prokurorisë dhe të pandehurit². Dhe për më keq, në vitin 2016, 44.5% e pafajësive në SHBA kishin të bënin me të pandehur që kishin pranuar fajësinë pas një marrëveshjeje mbi pranimin e fajësisë³, gjë që sugjeron fort se të pandehur të pafajshëm mund të shtyhen (në të vërtetë, mund të thuhet: të detyrohen) që të pranojnë fajësinë për të shmangur një gjykim me një rezultat të pasigurt (por nëse shpallen fajtor, padyshim, më të keq për ta).

Duke iu kthyer sistemit gjyqësor shqiptar, aktualisht ekzistojnë pesë procedura të veçanta që synojnë shkurtimin e procedimeve penale, të parashikuara dhe të rregulluara sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP) ose Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Dy prej tyre, përkatësisht gjykimi i drejtpërdrejtë dhe urdhri penal, mund të nisen vetëm nga prokurori dhe vlerësimi i tij⁴; tre të tjerat (përkatësisht gjykimi i shkurtuar, gjykimi me marrëveshje dhe shmangia nga ndjekja penale për të miturit) kërkojnë

- 2 Gjykata Supreme e SHBA, Missouri kundër Frye, 566 SHBA 134, 2012, në dispozicion në anglisht në: <https://supreme.justia.com/cases/federal/us/566/134/>
Në referencën e tij të “tregtisë së kuajve”, gjykatësi Kennedy po citonte fjalë për fjalë një artikull shkencor të vitit 1992 mbi marrëveshjet e pranimit të fajësisë: shih Robers E. Scott dhe William J. Stuntz, *Plea-Bargaining as a Social Contract*, 101 Yale LJ 1909 (1992), 1912.
- 3 Fair Trials International Submission to the UN Office of the High Commissioner for Human Rights report on the implementation of the UNGASS Outcome document on the world drug problem, in regard to human rights, maj 2018, faqja 4.
- 4 Duhet të theksohet se kur informohet për fillimin e procesit të gjykimit të drejtpërdrejtë kundër tij ose kur kundërshton një urdhër ndëshkimi të lëshuar kundër tij, i pandehuri ka të drejtë të kërkojë gjykim të shkurtuar.

pëlqimin e të pandehurit dhe kështu mund të konsiderohen si procedura të “*pastra*” të heqjes dorë nga gjykimi. Udhëzuesi aktual do të vendosë theksin në gjykimet e shkurtuara (të cilat nisen ekskluzivisht nga i pandehuri para gjyqtarit të seancës paraprake dhe nuk kërkojnë pranimin e fajësisë) dhe gjykimet me marrëveshje (të cilat mund të propozohen nga prokurori dhe kërkojnë konfesionin e të pandehurit), pasi deri më tani ato përbëjnë mekanizmat më të përhapura të heqjes dorë nga gjykimi në sistemin gjyqësor shqiptar.

Kështu, megjithëse informacioni statistikor gjithëpërfshirës nuk është i disponueshëm, në bazë të informacionit të mbledhur nga burime të ndryshme, si dhe përgjigjeve ndaj kërkesave për informacion të paraqitura në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, nga 3,092 çështje dërguar për gjykim në vitin 2019, në 2,450 çështje (që përfshijnë 2,824 të pandehur) të pandehurit paraqitën kërkesë për gjykim të shkurtuar⁵. Sipas të njëjtit burim dhe gjatë të njëjtit vit (2019), u kryen 150 gjykime me marrëveshje (20,4% e totalit)⁶. Me fjalë të tjera, të pandehurit kërkuan gjykim të shkurtuar, në pothuajse 80% të çështjeve penale të regjistruara atë vit nga Prokuroria e Tiranës. Interesant është fakti se, sipas një studimi të vitit 2019, të bërë nga Res Publica, nga 2,999 çështje të Gjykatës së Rrethit, Tiranë që mund të jenë potencialisht objekt i një gjykimi me marrëveshje (dmth. çështje që lidhen me veprat penale që dënohen me një burgim maksimal prej shtatë vjet) në 2018, ky lloj gjykimi u përdor në vetëm 359 çështje, pra në 12% të çështjeve të mundshme⁷. Thënë sa më sipër duket se numri i gjykimeve me

marrëveshje të kryera në Gjykatën e Rrethit Tiranë nga viti 2018 në 2019 u përgjysmua, edhe pse ka dëshmi se marrëveshje të tilla janë në favor të të pandehurit, pasi dënimi i dhënë në kontekstin e gjykimeve me marrëveshje është mesatarisht 15% më i ulët se ai në gjykimet sipas procedurës së zakonshme ku të pandehurit përballeshin me akuza të njëjta.⁸

Udhëzuesi aktual përmban tre pjesë. Në pjesën e parë paraqitet një pasqyrë e kuadrit ligjor vendas dhe jepet informacion mbi gjendjen aktuale të çështjeve që kanë të bëjnë me aksesin në avokat, qasjen në dosjen e çështjes dhe barazinë e armëve në kontekstin e gjykimeve të shkurtuara dhe gjykimeve me marrëveshje.

Pjesa e dytë përmban një sërë sugjerimesh, ku përfshihen argumente të mundshme ligjore në lidhje me strategjitë, e bazuar në litigim/proces gjyqësor që mund të përdoren me qëllim që të anojnë negociatat në favor të të pandehurit dhe të sigurojnë që pranimi për heqjen dorë nga gjykimi të jetë sa më i lirë dhe sa më i informuar që të jetë e mundur ose për të vazhduar me metaforën e *tregtisë së kuajve* më sipër, që me çmimin e heqjes dorë nga disa prej të drejtave të tij, i pandehuri të mund të blejë një kalë dhe jo një gomar.

Pjesa e tretë dhe e fundit paraqet një numër rekomandimesh për palët e interesura, me qëllim ndryshimin e kuadrit ligjor dhe rregullator dhe sigurimin e një negociimi/marrëveshje më të barabartë midis autoriteteve gjyqësore dhe të pandehurve. Duke vepruar kështu, autorët e këtij udhëzuesi pranojnë se pavarësisht nga mangësitë e shumta, mekanizmat e ndryshëm të heqjes dorë nga gjykimi do të vazhdojnë të jenë një element qendror i sistemit shqiptar të drejtësisë penale, sikur për të vetmen arsye që, sipas vëzhgimit të një prokurori shqiptar,

5 Shkresat e Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë me nr ref. 71/Q dhe 4421/a, datë 5/2/2020 dhe 22/4/2020.

6 Shkresat e Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë me nr ref. 71/Q, datë 5/2/2020.

7 Marrëveshjet e fajësisë, Res Publica, 2019, në: <http://www.respublica.org.al/wp-content/uploads/2021/10/marrevshjet-e-fajesisë-2019-web.pdf> fq 35.

8 Po aty, faqja. 41.

pjesë e eventit për shkëmbimin e përvojës organizuar në qershor 2021, në kontekstin e projektit kërkimor në fjalë, *“nëse beqjet dorë nga gjykimi do të shfuqizoheshin sot, sistemi i drejtësisë penale do të rrëzohet që nesër”*.⁹

9 Cituar nga pjesëmarrësi S.Q. (inicialet janë ndryshuar me qëllim mbrojtjen e të dhënave), në eventin për shkëmbimin e përvojës, mbajtur më 25 qershor 2021, në Tiranë, Shqipëri.

PJESA A:

E DREJTA E BRENDSHME DHE GJENDJA AKTUALE

1. Aksesimi në avokat

Ligji vendas

Neni 28 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që kushdo, të cilit i hiqet liria, ka, mes të drejtave të tjera, të drejtën për të komunikuar menjëherë me avokatin, ndërsa neni 31 (ç) parashikon që çdokush ka të drejtën të mbrohet me ndihmën e një avokati mbrojtës gjatë procesit penal.

Sipas Kodit të Procedurës Penale (në vazhdim do të referohet si KPP), baza e saktë ligjore për të drejtën për t'u mbrojtur me avokat (qoftë i marrë privatisht apo i caktuar nga shteti) varet nga statusi i të dyshuarit / të akuzuarit në kohën e marrjes në pyetje. Edhe pse në përgjithësi të dyshuarit/të akuzuarit në liri gëzojnë pothuajse të njëjtën të drejtë për të patur avokat si personat e ndaluar / arrestuar, një ndryshim i rëndësishëm është se personat e dyshuar/të akuzuar në gjendje të lirë nuk kanë të drejtën e një takimi konfidencial me avokatin e tyre para se të merren në pyetje për herë të parë, siç ndodh me personat e dyshuar / të akuzuar që janë ndaluar ose arrestuar;

në raste të tilla, personi i arrestuar / ndaluar ka të drejtë të konsultohet me avokatin e tij mbrojtës menjëherë pas arrestimit dhe para se të pyetet nga policia, dhe caktimi i një avokati (privatisht ose i caktuar nga shteti) është i detyrueshëm. E drejta për të pasur avokat përmendet gjithashtu në Letrën e të Drejtave që i dorëzohet të dyshuarit/akuzuarit para marrjes në pyetje për herë të parë. Ai (pavarësisht nëse i është hequr liria apo jo) do të pyetet nëse i ka kuptuar të drejtat e tij (përfshirë të drejtën për avokat) të parashikuara në Letrën e të Drejtave; deklaratat e bëra para se i dyshuari / i akuzuari të jetë informuar për të drejtat e tij, nuk janë të pranueshme.

KPP gjithashtu përmban një numër masash mbrojtëse shtesë që synojnë të sigurojnë që një i dyshuar / i akuzuar të jetë në gjendje të përfitojë ndihmë juridike. Kështu pyetja para prokurorit duhet të bëhet në prani të avokatit të zgjedhur privatisht ose atij të caktuar nga shteti. Në mënyrë të ngjashme, një i pandehur që ndodhet jashtë shtetit të cilit është mohuar ekstradimi, mund të merret në pyetje me lidhje/mjete audio-vizive, me kusht që ligji i shtetit në të cilin ai ndodhet të sigurojë praninë e avokatit të

të pandehurit në vendin e marrjes në pyetje, ndërsa procedurat e njohjes duhet të bëhen në prani të avokatit mbrojtës.

Pas përfundimit të hetimit nga prokurori dhe paraqitjes së një kërkesë drejtuar gjykatës për të çuar çështjen në gjykim, gjykata duhet të shqyrtojë nëse i pandehuri ka zgjedhur një avokat; nëse jo, gjykata do të caktojë një të tillë nga shteti pasi prania e një avokati mbrojtës është e detyrueshme. Në mënyrë të ngjashme, gjykata që shqyrton ligjshmërinë e arrestimit dhe ndalimit të personit të arrestuar / ndaluar duhet të sigurojë praninë e avokatit mbrojtës; nëse ai nuk paraqitet, atëherë gjykata do të caktojë një avokat nga shteti, pasi prania e një avokati mbrojtës është e detyrueshme.

Dispozitat e mësipërme janë gjithashtu të zbatueshme në rastet kur personat që paraqiten para një autoriteti procedues dhe pa statusin e të pandehurit, bëjnë deklarata vetë-inkriminuese. Zyrtari hetues duhet të përfundojë marrjen në pyetje dhe t'i informojë ata se kundër tyre mund të nisë një procedim penal, si dhe t'i këshillojë ata të marrin një avokat. Deklaratat e bëra më parë nga ata nuk mund të përdoren kundër tyre.

Duke iu kthyer më konkretisht të drejtave procedurale në kontekstin e proceseve të heqjes dorë nga gjykimi, të pandehurit që duan të kërkojnë një gjykim me marrëveshje ose një gjykim të shkurtuar ose (në rastet e të miturve) shmangje të ndjekjes penale dhe marrjen e masave alternative, gëzojnë të gjitha të drejtat që kanë të pandehurit deri në momentin kur ata shprehin vullnetin për të përfituar nga një prej mekanizmave të heqjes dorë nga gjykimi.

Lidhur me praninë e avokatit në kuadrin e procedurave të heqjes dorë nga gjykimi, kujtojmë se negociata të tilla zhvillohen në mënyrë efektive vetëm në kontekstin e gjykimeve me marrëveshje dhe masave

alternative për të miturit; në lidhje me gjykimet e shkurtuara, e drejta për të kërkuar një avokat i takon vetëm të pandehurit. Në të dy rastet e para (në gjykimet me marrëveshje dhe masat alternative për të miturit), prania e avokatit mbrojtës është e detyrueshme dhe prej saj nuk mund të hiqet dorë (Neni 406/d (2) KPP, Neni 49 (1) (e) KPP, Neni 48 (4), 59 (3), (4) Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit. Nuk ka asnjë dispozitë përkatëse për të pandehurit që kërkojnë gjykim të shkurtuar; megjithatë sipas nenit 331 të KPP, të pandehurit që paraqiten para gjyqtarit të seancës paraprake kanë të drejtë për ndihmë juridike të detyrueshme ligjore, dhe duke pasur parasysh që sipas nenit 403 (1) të KPP kërkesat për një gjykim të shkurtuar mund të paraqiten vetëm tek gjyqtari në fjalë, në praktikë dhe sipas dispozitave ligjore të zbatueshme përgjithësisht, edhe të pandehurit që mendojnë të kërkojnë një gjykim të shkurtuar do të përfaqësohen me një avokat.

Gjendja aktuale - problemet e identifikuara

Sipas profesionistëve të ndryshëm juridikë të konsultuar zyrtarisht dhe jozyrtarisht për qëllimet e këtij studimi, nuk ka dëshmi se policia / prokurorët ushtrojnë presion të drejtpërdrejtë ndaj të pandehurve ose avokatëve të tyre që ata të kërkojnë një nga procedurat e lartpërmendura të heqjes dorë nga gjykimi. Thënë këtë, karakteristika të caktuara të sistemit shqiptar të drejtësisë penale mund të konsiderohen se kanë një ndikim të rëndësishëm në vendimin e të pandehurve për të kërkuar një gjykim të shkurtuar ose një gjykim me marrëveshje.

Një problem i veçantë i identifikuar në gjykimet e shkurtuara në kontekstin e studimit aktual ka të bëjë me modalitetet

nën të cilat paraqiten kërkesa të tilla. Sipas avokatëve praktikues të konsultuar për qëllimet e këtij udhëzuesi, klima në dhomat e gjyqtarëve ku mbahet seanca paraprake pas përfundimit të hetimit penal nga prokurori, është mjaft e tensionuar. Vihet re se pas ndryshimit të KPP në 2017, i pandehuri duhet të paraqesë një kërkesë për një gjykim të shkurtuar (Neni 403 (1) KPP). Shpesh gjyqtari i seancës paraprake e hap diskutimin duke pyetur të pandehurin dhe avokatin e tij nëse duan një gjykim të shkurtuar. Avokatët u shprehën se një përgjigje negative ndaj kësaj pyetjeje, bashkë me kërkesën për mbledhjen e provave shtesë (dhe sidomos provave shfajësuese) që nuk janë mbledhur nga prokurori, shpesh shkakton mërzë të dukshme të gjyqtarit, i cili është më shumë i prirur të refuzojë kërkesat për prova shtesë, duke vënë në dukje se dosja e çështjes është e plotë dhe duke përsëritur pyetjen, nëse i pandehuri dëshiron të kërkojë një gjykim të shkurtuar. Në këtë pikë, i pandehuri duhet të marrë një vendim në punë sekondash. Ose të heqë dorë dhe të kërkojë një gjykim të shkurtuar ose të përgjigjet se preferon një gjykim sipas procedurës së zakonshme. Në rastin e fundit, i pandehuri tashmë ka humbur mundësinë për të ulur një të tretën e dënimit përfundimtar dhe nuk ka arritur të sigurojë mbledhjen e provave shtesë në atë kohë - një konsideratë e rëndësishme, kjo nëse informacioni duhet të sigurohet në një kohë të shpejtë.

Sikur të mos mjaftonte kjo, i pandehuri që kërkon gjykim sipas procedurës së zakonshme, e ka të vështirë të besojë se ka gjasa të mira për t'u liruar nga gjykata. Siç u përmend më lart, 80% e çështjeve në Gjykatën e Rrethit Tiranë (Shkalla e Parë) u shqyrtuan sipas procedurës së gjykimin të shkurtuar. Duke marrë parasysh që në procedura të tilla i pandehuri nuk pranon fajësinë, do të ishte e arsyeshme të mendohej se një numër i konsiderueshëm i këtyre çështjeve mbyllet me shpalljen e

pafajësisë së të pandehurit. Megjithatë, siç u pa, shkalla e përgjithshme e pafajësisë për Gjykatën e Tiranës (Shkalla e Parë) në vitin 2020 ishte 2,9%; dhe megjithëse nuk ka informacion mbi përqindjen e vendimeve të shkallës së parë të pranuar / rrëzuara në apel, të dhënat anekdotike sugjerojnë se kjo përqindje nuk ndryshon shumë. Sa më sipër sugjeron që kërkesa për një gjykim të shkurtuar perceptohet nga gjyqtarët si një pranim i nënkuptuar i fajësisë (ndaj dhe numri disi i ulët i vendimeve të pafajësisë). Kjo çon që i pandehuri të jetë në një dilemë mjaft të palakmueshme duke u vënë para zgjedhjes brenda pak minutash, në seancën paraprake mbajtur në dhomat e gjyqtarëve dhe në prani të prokurorit ku ose kërkon gjykim të shkurtuar, duke hequr dorë nga të drejtat e tij, duke e ditur se ka shumë të ngjarë që të shpallet fajtor, por të paktën do të përfitojë reduktimin e dënimit me një të tretën dhe do të shihet si “bashkëpunues” në sytë e prokurorit dhe gjykatës, duke rritur kështu shanset për një dënim më të ulët, ose i pandehuri nuk do të kërkojë gjykim të shkurtuar dhe kështu mund të ushtrojë të drejtat e plota procedurale, por me dijeninë se gjyqtari me shumë gjasa nuk do të kërkojë mbledhjen e provave shtesë, se ai do të konsiderohet si “jo-bashkëpunues” nga prokurori, gjyqtari i seancës paraprake dhe në fund gjykata, pa përfitur ndonjë shans më të madh për t'u shpallur i pafajshëm, duke marrë parasysh shkallën shumë të ulët të vendimeve të pafajësisë në përgjithësi.

Për sa më sipër, mund të kuptohet pse, pavarësisht nga aftësitë e tyre juridike dhe përvoja profesionale, dhe pavarësisht nga natyra e veprës penale / rrethanat personale të të pandehurit (p.sh. nëse ai i përket një grupi vulnerabël) si avokatët privatë, ashtu edhe ata të caktuar nga shteti, kanë më shumë të ngjarë t'u rekomandojnë klientëve të tyre që të kërkojnë gjykim të shkurtuar pasi duke kërkuar gjykimin e shkurtuar, të pandehurit

kanë shumë për të fituar dhe pak për të humbur. Avokatët e tyre nuk do vepronin në mënyrë profesionale nëse nuk do t'ua vinin në dukje këtë klientëve të tyre. Dhe me të vërtetë, në një mostër mjaft të vogël prej 100 çështjesh me akuza të krahasueshme, të ndara në mënyrë të barabartë midis çështjeve kur i pandehuri përfaqësohej nga avokatë të caktuar nga shteti dhe atyre të marrë privatisht, rezultoi që në 49 nga 50 çështjet e kategorisë së parë dhe në 45 nga 50 çështjet e kategorisë së dytë, të pandehurit kërkuan gjykim të shkurtuar¹⁰. Ky model dëshmohej gjithashtu nga studimet e mëparshme të kryera nga qendra Res Publica: në bazë të një krahasimi midis 50 çështjeve kur i pandehuri përfaqësohej nga një avokat kryesisht dhe 50 çështjeve të krahasueshme, kur i pandehuri përfaqësohej nga një avokat privat, avokatët e ndihmës juridike kërkuan gjykim të shkurtuar në 98% të rasteve, ndërsa avokatët e marrë privatisht në 90% të rasteve.¹¹

Duke iu kthyer gjyqimeve me marrëveshje, nuk janë vënë re problematika të ngjashme. Në të vërtetë, fakti që numri i kërkesave për gjyqime me marrëveshje është mjaft i ulët, duket se konfirmon konstatimin se të pandehurve nuk iu bëhet presion që të kërkojnë gjykim me marrëveshje. Për më tepër, shumica e gjyqimeve me marrëveshje duket se janë të favorshme për të pandehurit që i kërkojnë ato. Në bazë të një sondazhi të kryer nga Res Publica bazuar në një mostër prej 100 çështjesh (50 të gjykuara sipas procesit të zakonshëm gjyqësor dhe 50 të përfunduara me anë të një gjykimit me marrëveshje), dënimi i dhënë në rastin e gjyqimeve me marrëveshje u gjet se ishte mesatarisht 15% më i ulët se ai i dhënë në proceset e gjykuara sipas procedurës së

zakonshme, kur të pandehurit përballeshin me akuza identike; madje, në disa raste, dënimet e dakordësuar midis prokurorit dhe të pandehurit ishin 65% deri 70% më të ulëta, se ato të caktuara nga gjykata në rastin e gjykimit të zakonshëm. Megjithatë, për disa vepra penale, si mashtrimi me sigurimet dhe mosbindja ndaj urdhrit të policisë, në rastin e marrëveshjeve të fajësisë prokurorët kërkuan dhe gjykatat dhanë një dënim respektivisht 15% dhe 85% më të lartë, se ai i dhënë nga gjykatat për të njëjtat vepra, por të gjykuara sipas procedurës së zakonshme gjyqësore. Kjo tregon qartë se ndërsa prokurorët në përgjithësi e mbajnë anën e tyre të marrëveshjes dhe janë të gatshëm të bëjnë kompromis për kohëzgjatjen e dënimit, ka një praktikë që tregon se cilat janë veprat penale që mund të përfitojnë nga ulja e dënimit në kontekstin e vendimeve me marrëveshje¹², ku prokurorët vendosin (dhe gjykatat miratojnë vendimin e tyre).

Lidhur me rolin e avokatëve në rastin e gjyqimeve me marrëveshje, studimet e mëparshme të kryera nga Res Publica sugjerojnë se avokatët e caktuar nga shteti janë dukshëm më të suksesshëm në sigurimin e marrëveshjeve të favorshme të fajësisë për klientët e tyre sesa avokatët privatë; kështu në disa çështje dhe për të njëjtat vepra, avokatët e caktuar nga shteti pas një gjykimi me marrëveshje arritën të sigurojnë për klientët e tyre një dënim 40% më të ulët se ai i siguar nga avokatët e marrë privatisht - ku në fakt, vetëm për njëriën prej veprave penale të studiuara (vjedhje) nuk u vu re ky fenomen, pasi dënimet e siguruara nga avokatët privatë ishin tre herë më të ulëta se ato të siguruara nga avokatët e caktuar nga shteti¹³. Për më tepër, duket gjithashtu se disa nga avokatët e caktuar nga shteti (të cilët në fakt caktohen

10 Marrëveshjet e fajësisë, Res Publica, 2019, op.cit., faqja 7.

11 Effectiveness of Legal Aid in Criminal Proceedings in Albania: How Far Are We From International Standards?, (anglisht) Qendra Res Publica, 2016, faqja 113.

12 Marrëveshjet e fajësisë, Res Publica, 2019, op.cit., faqja 41.

13 Po aty, op.cit., faqja 40

nga prokurori) kanë më shumë gjasa sesa të tjerët për të përfaqësuar të pandehurit; nga 162 çështje ku prokurori caktoi një total prej 46 avokatësh për të përfaqësuar të pandehurit, tre avokatë u caktuan në 35% të rasteve¹⁴. Këto dy elemente të kombinuara (domethënë fakti që avokatët e caktuar nga shteti duket se po bëjnë një punë më të mirë në sigurimin e marrëveshjeve më të mira të pranimit të fajësisë dhe se disa avokatë të caktuar nga shteti kanë më shumë gjasa të caktohen nga prokurorët) mund të jetë një tregues se prokurorët në mënyrë jo formale “bindin” të pandehurit të mos marrin një avokat privatisht, por të pranojnë të përfaqësohen nga avokati i shtetit i caktuar

nga prokurori, në mënyrë që të përfitojnë një marrëveshje më të mirë pranimit të fajësisë, siç u vërejt edhe në Gjeorgji, *në vijim të procedimit mbi institucionin e marrëveshjes për pranimin të fajësisë*¹⁵. Thënë këtë, duhet të theksohet në këtë drejtim se në Nëntor 2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i sapokrijuar, miratoi një rregullore në lidhje me caktimin e avokatëve të ndihmës juridike; besohet se sistemi i ri, i bazuar në rotacion, do të kufizojë diskrecionin e prokurorëve në caktimin e avokatëve të ndihmës juridike.

14 Po aty, faqja 42

15 Transparency International, *Plea Bargaining in Georgia: Negotiated Justice*, 2010, faqja 17.

Praktika të mira

Në Itali, edhe nëse kërkesa për gjykim të shkurtuar refuzohet nga gjyqtari i seancës paraprake, i pandehuri mund të kërkojë një gjykim të shkurtuar nga gjyqtari i seancës paraprake para paraqitjes së përfundimeve nga palët (neni 438 (6) të KPP) ose nga gjyqtari i çështjes (sipas interpretimit të miratuar nga Gjykata Kushtetuese Italiane në vendimin e saj nr. 127/2021). Kjo nënkupton që si i pandehuri ashtu edhe avokati mbrojtës kanë më shumë kohë në dispozicion për të hartuar një strategji të duhur mbrojtjeje.

Në Angli dhe Uells, udhëzimet e miratuara nga Këshilli i Dënimit parashikojnë që sa më herët në proces i pandehuri të deklarojë pranimin e fajësisë, aq më e madhe është ulja e dënimit që do të jepet nga sa parashikohet. Kështu, nëse një i pandehur bën një kërkesë të tillë në fazën e parë të procesit, ai do të përfitojë nga një e treta e uljes së dënimit – që është ulja maksimale që mund të jepet. Nëse ai bën një kërkesë të tillë në seancën e dytë dëgjimore, atëherë do të përfitojë një ulje dënimi me një të katërtën. Së fundmi, nëse ai vendos të pranojë fajësinë në ditën e parë të gjykimit në themel, atëherë ulja maksimale e dënimit që do të jepej është një e dhjeta. Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i këtyre rregullave nuk është automatik, por ka përjashtime: kështu që nëse gjykata konstaton se ishte objektivisht e pamundur që i pandehuri të paraqiste një deklaratë fajësie më shpejt, sesa ai e paraqiti në realitet, atëherë ai ende do të kishte të drejtën e uljes së një të tretës së dënimit (Këshilli i Dënimit, Udhëzues për uljen e dënimit për pranimin e fajësisë, Mars 2017). Si në rastin e Italisë, të pandehurit dhe avokatët e tyre kanë më shumë mundësi për të deklaruar pranimin e fajësisë, që do të thotë se ata kanë më shumë kohë në dispozicion për të shqyrtuar dosjen e çështjes dhe për të mbledhur prova shfajësuese.

2. Aksesi tek dosja e çështjes

Ligji vendas

Nuk ka parashikime të veçanta mbi njohjen me dosjen në procedurat e veçanta të heqjes dorë nga gjykimi, ndaj zbatohet kuadri i përgjithshëm ligjor. Të dyshuarit / të pandehurit informohen për akuzat pas arrestimit, por zakonisht nuk informohen për arsyet që kanë bërë të nevojshëm arrestimin e tyre (në krahasim me çdo masë tjetër). Kjo ndodh sepse policia bën një interpretim selektiv të nenit përkatës, nenit 34/b, të KPP. Konkretisht, ndërsa është e vërtetë që neni 34 / b paragrafi 1 shkronja b) i KPP parashikon që i arrestuari ose i ndaluar ka të drejtë të njihet me aktet, provat e nevojshme dhe arsyet e arrestimit ose ndalimit të tij/ saj, po sipas nenit 34 / b paragrafi 1 parashikohet e drejta e të arrestuarit për t'u informuar, në kohën më të shkurtër të mundshme për akuzat, si dhe bazat e akuzave kundër tij, e drejtë e cila në fakt përshkruhet edhe në pikën 1 të Letrës së të Drejtave.

Sa i përket gjykimeve të shkurtuara, i pandehuri ka të drejtë të njihet me dosjen e çështjes për herë të parë vetëm pas përfundimit të hetimit dhe para se prokurori të vendosë nëse do ta pushojë çështjen apo

do ta çojë atë për gjykim (neni 327 (3), (6) i KPP) Lidhur me gjykimet me marrëveshje, dispozitat përkatëse nuk përmbajnë ndonjë të drejtë (ose ndalim) të veçantë në këtë drejtim. Ndaj, duket se sipas dispozitës së përgjithshme në lidhje me aksesin në dosjen e çështjes (neni 327 (3) i KPP), të pandehurit (dhe avokatit të tij) do t'i lejohet të marrë dosjen e çështjes pas përfundimit të hetimit dhe para se prokurori të vendosë nëse do ta pushojë çështjen apo do të kërkojë gjykim nga gjykata.

Gjendja aktuale - problemet e identifikuara

Sipas një avokati të konsultuar për qëllimet e këtij studimi, problemet me të cilat përballen avokatët në procedurat e heqjes dorë nga gjykimi janë të njëjtat probleme strukturore me të cilat përballen të gjithë avokatët penalistë, siç është fakti që shpesh zyrat e prokurorëve nuk u lejojnë avokatëve të njihen në kohë me dosjen e çështjes ose nuk lejojnë akses në dosje me pretekste të ndryshme, duke i detyruar kështu avokatët ose të studiojnë dosjen e çështjes në vend, ose në rastin më të mirë thjesht të fotografojnë dokumentet më të rëndësishme të dosjes me telefonat e tyre.

Praktika të mira

Në Luksemburg, ka një dispozitë specifike që i lejon të pandehurit të cilët tregojnë interes në heqjen dorë nga gjykimi (i njohur si “jugement sur accord”) të kenë qasje në dosjen e plotë penale të mbajtur nga prokuroria. Finlanda gjithashtu, siguron njohjen e plotë me dosjen para heqjes dorë nga gjykimi. Në juridiksione të tjera, megjithëse nuk ka dispozita specifike për sistemet e heqjes dorë nga gjykimi, regjimet e përgjithshme të njohjes me dosjen u japin të pandehurve akses të mjaftueshëm për t'u njohur me provat në kohën kur duhet të marrin vendimin për heqjen dorë nga gjykimi, siç është rasti në Gjermani ose Spanjë, ku në çdo rast të pandehurit marrin një kopje të të gjitha provave që mendohet të përdoren në gjyq para se t'u kërkohet të marrin një vendim për të hequr dorë nga e drejta e tyre për një gjykim të plotë (Fair Trials International, The Disappearing Trial, op. cit., faqe 52).

3. Barazia e armëve në fazën hetimore të procesit

Ligji vendas

Gjatë fazës së hetimit paraprak dhe para se të thirren për të vendosur nëse do të kërkojnë heqjen dorë nga gjykimi, të pandehurve u komunikohen të drejtat procedurale penale të parashikuara sipas pjesës së përgjithshme të KPP. Kështu, pas përfundimit të hetimit penal, i pandehuri njoftohet për këtë dhe i jepet një periudhë prej dhjetë ditësh që ai të paraqesë memorie e dokumente, t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, apo të kërkojë që të merret në pyetje (Neni 327 (4) KPP). Çdo vendim i prokurorit për të refuzuar kërkesën për mbledhjen e informacionit shtesë duhet të arsyetohet dhe të lëshohet brenda pesëmbëdhjetë ditëve (neni 327 (4), neni 110 (2) KPP).

Pas paraqitjes së kërkesës për gjykim të shkurtuar, të pandehurit nuk kanë të drejtë të kërkojnë mbledhjen ose / dhe paraqitjen e ndonjë prove ose informacioni në lidhje me rrethanat e krimin, përfshirë çdo provë shfajësuese. Sidoqoftë, ata mund të japin informacion mbi karakterin e tyre dhe rrethanat e tjera që ata besojnë se mund t'i ndihmojnë të shihen me sy të mirë dhe t'a çojnë gjykatën në uljen e mëtejshme të dënimit të tyre, pasi një informacion i tillë nuk konsiderohet si informacion i ri ose shtesë për qëllime të gjykimit, sepse nuk lidhet me rrethanat në të cilat është kryer krimi. Në mënyrë të ngjashme, gjykata mund t'i drejtojë pyetje të pandehurit në lidhje me gjendjen e tij personale, familjare ose financiare (neni 405 (7) KPP).

Lidhur me gjykimet me marrëveshje, duke qenë se kërkesa për një të tillë mund të paraqitet në çdo kohë nga fillimi i procedurës penale deri në seancën paraprake para gjykatës, kërkesat për mbledhjen e provave shtesë mund të paraqiten në bazë të dispozitave të përgjithshme ligjore. Çdo

provë shfajësuese ose provë tjetër, duhet të paraqitet tek prokurori dhe të përdoret si një mjet negociues për të siguruar një ofertë më të mirë për marrëveshje nga prokurori. Ndërsa të pandehurit do të dëgjoen nga gjykata, kjo e fundit nuk shqyrton çështjen, por thjesht sigurohet që janë përmbushur kriteret bazë të kualifikimit për kryerjen e gjykimit me marrëveshje. Kriteret e përmendura janë si procedurale (p.sh. nëse i pandehuri ka dhënë një pëlqim të informuar ose nëse ai i kupton kushtet e marrëveshjes) (Neni 406 (dh) KPP) ashtu edhe substanciale (p.sh. nëse provat e përfshira në dosjen e çështjes nuk mund të shërbejnë si bazë *prima facie* për dënimin e të pandehurit ose nëse dënimi është i papërshtatshëm në raport me veprën e kryer dhe personalitetin e të pandehurit; Neni 406/ë (1) (d) dhe (e) KPP respektivisht.

Gjendja aktuale - problemet e identifikuara

Ndoshta mangësia më e madhe në këtë rast është roli pasiv i mbrojtjes gjatë fazës hetimore të procesit. Duket se roli i saj është thjesht të vëzhgojë nëse prokurori po e bën si duhet punën e tij, në vend që të punojë për provimin e pafajësisë së klientit të tij. Megjithatë, prokurorët kanë tendencë të përqendrohen më shumë në mbledhjen e provave inkriminuese se sa atyre shfajësuese.

Në një masë të madhe, roli pasiv i avokatit është rezultat i kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij të mangët në praktikë. Kështu, ndërsa avokatët mbrojtës kanë të drejtë të kërkojnë nga prokurori mbledhjen e provave shtesë, prokurori nuk e ka detyrimin të pranojë kërkesa të tilla; vetëm kur i pandehuri kërkon të merret në pyetje, kuadri ligjor njih qartazi detyrimin nga ana e prokurorit për ta pranuar atë (neni 327 (4) KPP). Padyshim, çdo refuzim i kërkesës së të pandehurit për mbledhjen e informacionit shtesë duhet të shprehet me vendim të prokurorit dhe refuzimi me arsyetim të pamjaftueshëm mund të përdoret

si argument para gjykatës si provë e një hetimi joefektiv kundër të pandehurit; megjithatë në praktikë, prokurorët thjesht injorojnë kërkesa të tilla. Për më tepër, nëse i pandehuri vendos të kërkojë një nga dy proceset kryesore të heqjes dorë nga gjykimi, ai nuk do të mund të sjellë si argument vendimin e paarsyetuar mjaftueshëm të prokurorit - nëse ekziston një i tillë - që rrëzon kërkesën për mbledhjen e provave shtesë pasi ai do të ketë hequr dorë nga e drejta për ta bërë këtë.

Si rezultat i sa më sipër, dhe në dritën e shkallës jashtëzakonisht të ulët të pafajësisë (2,9% për të gjitha kundërvajtjet dhe krimet, në Gjykatën e Tiranës), duket se dosjet e çështjes përmbajnë pothuajse ekskluzivisht prova inkriminuese. Dhe megjithëse kjo jo domosdoshmërisht paraqet problem për gjykimet me marrëveshje, përderisa ekzistojnë mekanizma për të shqyrtuar nëse një vendim fajësie është i mbështetur nga provat e dosjes së çështjes (shih më poshtë), numri i ulët i pafajësisë në gjykimet e shkurtuara mund të sugjerojë se praktikisht kërkesa për gjykim të shkurtuar perceptohet si një pranim i nënkuptuar i fajit nga ana e të pandehurit, një perceptim i cili së bashku me mungesën e ndonjë prove shfajësuese në dosjen e çështjes, mund të çojë veçse në dhënien e një vendimi fajësie. Për më tepër, të dhënat sugjerojnë se kur shqyrtohen çështjet nën procedurën e gjykimit të shkurtuar, gjykatat nuk shqyrtojnë në mënyrën e duhur as materialet e përfshira në dosjen e çështjes, materiale që në mënyrë të arsyeshme mund të krijojnë përshtypjen se hetimi penal nuk ishte dhe aq i plotë. Një fenomen që u raportua të ndodhte në jug të Shqipërisë në vitin 2008 ishte se të moshuarit në shtëpitë e të cilëve u gjetën sasi të konsiderueshme droge, kërkonin menjëherë gjykim të shkurtuar dhe madje rrëfenin (institucioni i gjykimit me marrëveshje nuk ishte futur ende në rendin juridik shqiptar) se droga e sekuestruar u përkiste atyre. Kjo mjaftonte që prokurori të pezullonte hetimin për bashkëpunëtorë të mundshëm pasi “fajtori” ishte gjetur. Këta “mbretër” të moshuar të drogës përfitonin nga një e treta e

uljes së dënimit të tyre dhe me shumë mundësi do të dënoheshin me pezullim të dënimit me burgim dhe me dënim me kohë prove, për shkak të moshës së tyre të madhe. Ndërsa është e vështirë, madje pothuaj e pamundur të konstatohet se deri në çfarë mase ndodhin praktika të tilla sot, duket se të paktën në disa raste i pandehuri që kërkon një gjykim të shkurtuar është efektivisht personi i caktuar të marrë përsipër fajin. Një nga avokatët e konsultuar për udhëzuesin në fjalë solli si shembull një rast të vjedhjes së energjisë elektrike të kryer nga burri, ku gruaja pranoi “fajin” dhe kërkoi një gjykim të shkurtuar, me shpresën se si grua, gjykata mund të ishte më e butë ndaj saj dhe përveç uljes me një të tretën, do ta ulte edhe më shumë dënimin. Prokurori nuk e vazhdoi hetimin dhe në një seancë gjyqësore që zgjati shprehimisht një minutë, ajo u shpall fajtores për vjedhje të energjisë elektrike dhe u dënua me një dënim mjaft të lehtë alternativ me kohë prove.

Duke iu kthyer gjykimeve me marrëveshje, dispozitat përkatëse ligjore parashikojnë në mënyrë të qartë që gjykata, kur shqyrton marrëveshjen e propozuar, duhet të vlerësojë midis të tjerave nëse dosja përmban prova që dëshmojnë fajësinë e të pandehurit. Sidoqoftë, në praktikë, duket se gjykatat nuk ushtrojnë një kontroll shumë të rreptë ndaj gjykimeve të propozuara me marrëveshje. Nga një kampion prej 460 çështjesh, për të cilat prokurori paraqiti në gjykatë kërkesë për gjykim me marrëveshje, kërkesa u rrëzua nga gjykata në vetëm 12 % të rasteve, ku arsyet kryesore të rrëzimit nuk kishin të bënin me procesin e vendimarrjes së prokurorit, ndonjë abuzim tjetër, apo mungesën e kontrollit nga ana e tij për të parë p.sh. nëse gjykimi sipas procedurës së marrëveshjes ishte i zbatueshëm për veprën në fjalë ose nëse pëlqimi i të pandehurit për të lidhur një marrëveshje të tillë ishte i qartë. Nuk u identifikua asnjë çështje ku gjykata refuzoi marrëveshjen e propozuar (sipas arsyeve për refuzimin e një gjykimi me marrëveshje të parashikuar sipas nenit 406/ë (1) (d) dhe (e)).¹⁶

Pjesë e ngurrimit të gjykatave për t'i nënshtruar një kontrolli të rreptë, gjykimet me marrëveshje mund të jetë vetë natyra e veprave që zakonisht janë objekt i procedurave të tilla. Sipas një gjyqtari të konsultuar për qëllimet e këtij studimi, gjykimet me marrëveshje kryesisht merren në rastet që paraqesin një rrezik të ulët deri në të moderuar shoqëror, të tilla si ngarja e automjetit nën ndikimin e alkoolit, vjedhja e energjisë elektrike dhe ndërtimet pa leje. Ky vëzhgim mbështetet nga studimet e mëparshme të kryera nga Res Publica, e cila evidentoi se në vitin 2019 dhe në katër muajt e parë të vitit 2020, përkatësisht 18% dhe 17% të rasteve të vjedhjes së energjisë elektrike (166), ndërtimet pa leje (144), procedurat ishin përfunduar me anë të

një marrëveshjeje gjyqimi, ndërsa për vepra të tilla si falsifikimi i vulave (1 nga 62), dhuna në familje (7 nga 354) dhe ngacmimet (1 nga 58) marrëveshjet e fajësisë ishin në masën më pak se 2%.¹⁷ Meqenëse këto vepra janë në skajin e poshtëm të spektrit të kriminalitetit, së bashku me faktin se siç shihet, në shumicën e rasteve prokurorët priren të jenë zemërgjerë në uljen e dënimit që ofrojnë, duket se i bëjnë gjyqtarët të mendojnë se në përgjithësi marrëveshja e propozuar është veçanërisht e dobishme për të pandehurin dhe ndaj nuk e kontrollojnë me imtësi atë.

17 Marrëveshjet e fajësisë, Res Publica, 2019, faqe 33.

Praktika të mira

Në Itali, neni 438 (5) i Kodit të Procedurës Penale i lejon të pandehurit të kushtëzojnë kërkesën e tyre për një gjykim të shkurtuar me mbledhjen e provave të reja. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake i cili duhet të japë një vendim të arsyetuar nëse kërkesa për prova është e nevojshme apo jo. Kjo forcon pozitën e të pandehurit në kontekstin e procedurave të gjyqimit të shkurtuar dhe siguron mbikëqyrje gjyqësore mbi prokurorin. Duhet të theksohet se të pandehurit i jepen mundësi të shumta për të paraqitur kërkesa për gjykim të shkurtuar. Kështu ai mund të paraqesë një kërkesë me kusht për një gjykim të shkurtuar së bashku me një kërkesë të zakonshme për një gjykim të shkurtuar (neni 438 (5) bis i Kodit të Procedurës Penale). Në këtë mënyrë, nëse e para refuzohet, i pandehuri ka siguruar përfitimet që rrjedhin nga aplikimi i një gjykimi të shkurtuar.

Në Gjermani, Ligji për Marrëveshjet në Procedurat Penale, i interpretuar pas një vendimi të Gjykatës Supreme Gjermane në Çështje Penale (BGHSt 50, 40-64, 3 Mars 2005), parashikon që deklaratat vetë-inkriminuese të lëshuara në kontekstin e marrëveshjeve të pranimit të fajësisë duhet të jenë mjaftueshëm të detajuara dhe konkrete dhe të bazuara në provat e përfshira në dosjen e çështjes. Kjo do të thotë se rrëfimet që nuk mbështeten nga një minimum provash nuk mund të shërbejnë si bazë për një marrëveshje pranimi fajësie.

Gjithashtu në Gjermani, avokatët mbrojtës kanë të drejtën të fillojnë vetë një hetim me qëllim mbledhjen e provave shtesë si dhe kanë të drejtën për t'i kërkuar prokurorisë mbledhjen e provave shfajësuese; kërkesa të tilla zakonisht pranohen (Jenia I. Turner, Plea Bargaining and Disclosure në Gjermani dhe Shtetet e Bashkuara: Mësime Krahasuese, William and Mary Law Review, Vëllimi 57 (2015-2016), Çështja 4, faqe 1549-1560)



PJESA B:

SFIDIMI I MODALITETEVE TË APLIKIMIT TË HEQJES DORË NGA GJYKIMI NË SHQIPËRI

Meqenëse do të ishte joreale të kërkohej heqja e heqjes dorë nga gjykimet në përgjithësi, parashtrohet se objektivi i çdo fushate gjyqësore ose fushate advokimi duhet të jetë sigurimi i arritjes së një ekuilibri sa më të barabartë midis të pandehurit nga njëra anë dhe prokurorëve / gjykatave nga ana tjetër. Për këtë qëllim, në këtë pjesë do të përshkruajmë një sërë argumentesh që mund të paraqiten kryesisht në procedurat para gjykatave vendase dhe që më së shumti kanë lidhje me proceset e gjykimit të shkurtuar, pasi ato janë mekanizmi që prodhon më shumë heqje dorë nga gjykimi në Shqipëri.

Thënë këtë, ata që dëshirojnë të bëjnë një litigim strategjik, duhet të kenë parasysh konsideratën e mëposhtme: Sfidimi i modelit aktual të zbatimit të dy mekanizmave të heqjes dorë nga gjykimi kryesor do të jetë një proces i gjatë dhe i mundimshëm. Ka shumë të ngjarë që gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk do të jenë shumë të hapura ndaj argumenteve që në thelb kërkojnë të ndryshojnë praktikën e konsoliduar gjyqësore. Si rezultat, është pothuaj e sigurt që argumente të tilla fillimisht do kenë pak ose aspak sukses. Kjo është e pritshme pasi

forumet gjyqësore ku çështjet e ngritura prej tyre mund të trajtohen plotësisht dhe që kanë fuqinë të sjellin ndonjë ndryshim në praktikën gjyqësore janë Gjykata e Larta dhe Gjykata Kushtetuese. Ndaj është thelbësore të hartohet dhe zbatohet një strategji gjyqësore që do të sigurojë që argumentet e mëposhtëm të ngrihen para të gjitha instancave gjyqësore dhe veçanërisht para dy gjykatave të lartpërmendura.

1. Përdorimi i të gjitha mjetet procedurale që vë në dispozicion ligji shqiptar

Siç u tha më lart, neni 327 (4) i KPP parashikon që, pas përfundimit të hetimit, i pandehuri ka të drejtë të paraqesë prova si dhe të kërkojë nga prokurori mbledhjen e provave shtesë; për më tepër, sipas nenit 110 (2) të KPP -së, nëse prokurori vendos të refuzojë një kërkesë të tillë, ai duhet të nxjerrë një vendim për këtë qëllim.

Edhe pse në praktikë prokurorët nuk u përgjigjen këtyre kërkesave e për më tepër nuk nxjerrin vendime që arsyetojnë refuzimin e tyre, gjë që i bën avokatët të mos paraqesin

fare një kërkesë të tillë, parashtrohet se një plan qendror i një fushate litigimi për t'i bërë procedurat e heqjes dorë nga gjykimi më të barabarta duhet të fillojë nga paraqitja e kërkesave të tilla, duke i bërë thirrje prokurorit të mbledhë prova shfajësuese, që më pas mund të përdoren për të “ndikuar” në rastet e gjykimit me marrëveshje ose të mund të çojnë në lirim të pandehurit për çështjet e gjykuara, sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar.

Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se kërkesa të tilla nuk duhet të përcaktojnë vetëm se **cilat** prova duhet të mblidhen (p.sh. dëshmia e një dëshmitari okular), por gjithashtu duhet të tregojnë qartë **pse** duhet të mblidhen, duke theksuar se si ato mund të jenë vendimtare për rezultatin e gjykimit, ose si e forcojnë pozitën e të pandehurit në proces (p.sh. që dëshmia e dëshmitarit okular është vendimtare sepse mbështet argumentin e të pandehurit se po vepronte në vetëmbrojtje dhe hedh poshtë versionin e prokurorisë për ngjarjen sipas të cilit i pandehuri e vrau viktimën me gjakftohtësi) (shih për analogji, *Keskin kundër Holandës*, nr. 2205/16, 19 janar 2021, §§ 42-43). Atëherë do t'i takonte prokurorit të japë një përgjigje të arsyetuar nëse provat e kërkuara janë relevante dhe se pse mbledhja e tyre nuk është e mundur, ndërsa gjykata duhet të shqyrtojë nëse mungesa e mbledhjes së provave të përmendura ndikon në paanësinë e përgjithshme të procesit (*Keskin kundër Holandës*, op. cit., § 43).

Padyshim, në praktikën aktuale të prokurorisë kërkesa të tilla ka të ngjarë të mos miratohen dhe as nuk jepen vendime të arsyetuara për refuzimin e tyre. Sidoqoftë, kjo nuk mund t'i ndalojë avokatët mbrojtës që të theksojnë rëndësinë e këtyre kërkesave, duke informuar gjykatën se ato nuk u pranuan dhe duke i bërë thirrje gjykatës (veçanërisht në proceset me gjykim të shkurtuar) të rishikojnë nëse informacioni i kërkuar, por i pa mbledhur mund të ndikojë në rezultatin e procesit. Me fjalë

të tjera, avokatët nuk duhet t'i bëjnë thirrje gjykatës që të mbledhë provat në fjalë apo të kundërshtojë vlefshmërinë e provave të mbledhura (pasi një kërkesë e tillë do ta çonte gjykatën të konstatonte se i pandehuri e ka tërhequr kërkesën e tij për një gjykim të shkurtuar (neni 405 (7) KPP, duke humbur kështu uljen e një të tretës së dënimit) por duhet të kërkojë nga gjykata që të marrë parasysh rëndësinë, nëse ka, të provave, mbledhja e të cilave është kërkuar, por nuk është kryer gjatë fazës hetimore të procesit.

Megjithatë, nëse gjykata konstaton se ky argument nuk mund të pranohet pa tërhequr i pandehuri në mënyrë efektive kërkesën e tij për gjykim të shkurtuar, atëherë avokati mbrojtës mundet, në bazë të *Cani kundër Shqipërisë* (nr. 110066/06, 6 mars 2012), të pranojë vazhdimin e gjykimit nën gjykimin e shkurtuar, pa nënkuptuar domosdoshmërisht, për qëllime shterimi, që kërkesa është revokuar. Kujtojmë se në çështjen *Cani kundër Shqipërisë*, avokati i kërkuarit (i cili kishte kërkuar të gjykohej nën procedurën e gjykimit të shkurtuar) kërkonte dy herë nga gjykata e apelit për të siguruar pjesëmarrjen e aplikantit në gjykatë, diçka që kërkonte aprovim pasi ai ndodhej në burg. Sidoqoftë, të dyja rastet autoritetet nuk arritën ta shoqëronin ankuesin në gjykatë. Si rezultat, avokati i tij ra dakord që seanca të zhvillohej në mungesë të kërkuarit. Më pas, ai u ankua edhe para Gjykatës Kushtetuese që nuk u lejua të merrte pjesë në seancën para Gjykatës së Lartë, por Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë ankesën e tij me arsyetimin se bazat për të apeluar ishin jashtë juridiksionit të saj.

Para Gjykatës Evropiane, u ngrit pyetja nëse marrëveshja e avokatit të aplikantit për të vazhduar seancën para Gjykatës së Apelit në mungesë të kërkuarit përbente heqje dorë nga e drejta e tij për të marrë pjesë personalisht në seancën para gjykatës së apelit. Gjykata Evropiane, pasi vuri në dukje se procedura e gjykimit të shkurtuar sjell si pasojë pakësim të të drejtave

procedurale penale të të pandehurit, u shpreh se paraqitja e të pandehurit në gjykimin e tij është thelbësore në mënyrë që të respektohet e drejta e tij për një seancë para gjykatës dhe për të siguruar një gjykim të drejtë (op. cit., § 49). Gjykata vazhdoi të vinte në dukje se edhe pse ankuesi, si përfundim, kishte pranuar kryerjen e veprës penale, gjatë procesit me gjykim të shkurtuar, ai pretendoi se gjykata vendase nuk kishte marrë parasysh një sërë faktorësh lehtësues që ai do të kishte paraqitur në gjykatë, po të ishte lejuar të merrte pjesë në gjyq; në të vërtetë, për disa prej tyre (të tilla si pendimi për kryerjen e krimit) gjykatat vendase do të duhet të vlerësonin drejtpërdrejt sjelljen dhe qendrimin e tij gjatë seancës në mënyrë që të vlerësonin vërtetësinë e tyre (*Mitchedlishvili kundër Gjeorgjisë*, nr. 894/ 12, 25 shkurt 2021, § 38). Me fjalë të tjera, argumentet që ai synonte të paraqiste kishin një ndikim të drejtpërdrejtë në dënimin që do të merrte dhe si rezultat siguroi mbrojtjen e ofruar sipas nenit 6 të Konventës (*Cami kundër Shqipërisë*, op. Cit., § 55). Si rezultat, dështimi i autoriteteve për të siguruar praninë e tij në gjyq ishte në kundërshtim me nenin 6.

Kohët e fundit në një çështje kundër Kroacisë, Gjykata duket se ka miratuar nocionin se, pavarësisht nga rrëfimi/konfesimi i të pandehurit, duhet të mblidhen gjithsesi dëshmi lidhur me shkallën e përfshirjes së tij në kryerjen e krimit. Kështu në çështjen *Dodoja kundër Kroacisë* (nr. 53587/17, 24 qershor 2021 (ende e pa përfunduar) kërkuesi, në kuadër të procesit të zakonshëm, pranoi se ishte pjesë e një grupi të organizuar që blinte dhe shiste substanca narkotike, por kundërshtoi shkallën e përfshirjes së tij, duke vënë në dukje se kjo kishte qenë me ndërprerje. Sidoqoftë, sipas një deklaratë të një prej të bashkë akuzuarve të tij, përfshirja e aplikantit kishte qenë më domethënëse dhe kishte zgjatur një periudhë të konsiderueshme kohore. Por, problemi që u has ishte se personi i bashkë-akuzuar me aplikantin ishte larguar ndërkohë nga Kroacia

dhe nuk po gjendej që të çohet para gjykatës dhe të merrej në pyetje në seancë. Si rezultat, në mungesë të provave të tjera dhe në dritën e dëshmisë së kërkuarit, gjykata i kushtoi rëndësi deklaratës së të bashkë-akuzuarit në polici. Para Gjykatës, aplikanti pohoi se në asnjë fazë të procesit ai nuk pati mundësi të ballafaqohet me të bashkë-akuzuarin e tij, dhe argumentoi se ndërsa edhe pse ai vërtet kishte marrë pjesë në shitjen e narkotikëve, pjesëmarrja e tij ishte e kufizuar.

Ndërsa Gjykata nuk i gjeti me faj autoritetet për dështimin për të siguruar pjesëmarrjen e të bashkë-akuzuarit të aplikantit në gjyq, ajo vuri në dukje se, pavarësisht nga rrëfimi i aplikantit, dëshmia e të bashkë-akuzuarit të tij kishte një peshë të konsiderueshme dhe mund të ndikonte qartë në pozicionin e aplikantit në proces dhe përfundimisht në vendimin e gjykatës, duke qenë se e portretizonte aplikuesin si një anëtar më të rëndësishëm dhe aktiv të rrjetit kriminal, faktor që mund të kishte një ndikim të qartë në dënimin e tij (*Dodoja kundër Kroacisë*, op. cit., § 41, 46). Për më tepër, edhe pse Gjykata nuk vlerësoi që gjykatat vendase nuk duhet ta kishin marrë parasysh dëshminë e të bashkëakuzuarit, ajo konsideroi se gjykatat vendase kishin dështuar të merrnin masa adekuate, nëse ka, kundër-balancuese për të siguruar të drejtën e aplikantit për një gjykim të drejtë, i cili pa që dënimin e tij po rritej bazuar në dëshminë e një të bashkëakuzuari (i cili qartazi kishte motiv për të minimizuar shkallën e tij të pjesëmarrjes në grupin kriminal) dhe që të cilin ai nuk kishte arritur ta merrte në pyetje. Fakti që aplikantit i ishte dhënë mundësia të paraqiste çështjen e tij para gjykatës nuk përbënte një garanci të mjaftueshme në atë drejtim (Po aty, §§ 46-47).

Si përfundim, dhe në lidhje me çështjet kur i pandehuri mendon të paraqesë një kërkesë për gjykim të shkurtuar, është e rëndësishme që avokati mbrojtës t'i drejtojë kërkesa konkrete prokurorit në lidhje me mbledhjen e provave; siç u pa më lart, provat në fjalë mund të jenë jo vetëm shfajësuese, por edhe

prova që sqarojnë shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit, të tilla që mund të kenë ndikim në rëndimin e dënimit të tij. Nëse prokurori i refuzon, avokati mbrojtës duhet ta sjellë këtë refuzim në vëmendjen e gjykatës, jo për të kërkuar nga gjykata mbledhjen e provave shtesë, por më shumë për t'i bërë thirrje gjykatës të vlerësojë nëse provat që nuk ishin mbledhur mund të sillnin dyshime të arsyeshme për fajësinë e të pandehurit ose mund të kishin ndikim në shkallën e përgjegjësisë së tij penale. Nëse gjykata e konsideron këtë si një kërkesë të nënkuptuar për të mbledhur prova shtesë dhe thërret avokatin mbrojtës për të pyetur nëse i pandehuri do të donte të tërhiqte kërkesën për një gjykim nën procedurën e shkurtuar, avokati mbrojtës duhet të përgjigjet se ai tërheq kërkesën e tij, por se kërkesa dhe vendimi i gjykatës duhen të regjistrohen në procesverbalin e seancës (shih për analogji *Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë*, nr. 33192/07 dhe 33194/07, 25 qershor 2013, § 13, 94-95). Në këtë mënyrë, ai do të jetë në gjendje të vërtetojë pretendimin se argumenti është ngritur para gjykatës dhe se tërheqja e kërkesës nuk ka të bëjë me heqjen dorë, për aq sa gjykata duhet të ketë shqyrtuar *proprio motu* nëse provat e pa mbledhura mund të minojnë drejtësinë e përgjithshme të procesit – sikurse edhe gjykata duhet të kishte këmbëngulur në pjesëmarrjen personale të kërkuarit në gjyq në çështjen *Cani kundër Shqipërisë*.

2. Sjellja e argumenteve, bazuar në ligjin krahasues, me synimin për të evidentuar mungesën e masave të duhura mbrojtëse, në proceset që zhvillohen me procedurën e gjyqimit të shkurtuar sipas ligjit shqiptar

Ndërsa ka shumë praktika të mira ndërkombëtare në fushën e mekanizmave të heqjes dorë nga gjykimi, të cilave mund t'u referohemi, pohohet se do të ishte më e dobishme të përqendroheshim në zhvillimet

në këtë fushë në Italinë fqinje. Në të vërtetë, një tipar i dukshëm i modelit shqiptar të gjyqimit të shkurtuar është se, edhe pse u prezantua në 1995 dhe u modelua sipas atij italian (*guidizio abbreviato*), ai nuk shoqërohet me një set të ngjashëm masash mbrojtëse. Kështu për shembull, të pandehurit në Itali kanë të drejtë të kushtëzojnë kërkesën e tyre për një gjykim të shkurtuar me mbledhjen e provave shtesë (*guidizio abbreviato conditionato*, neni 438 (5) KPP italiane). Është e rëndësishme të theksohet këtu se një kërkesë e tillë paraqitet drejtpërdrejt tek gjyqtari i seancës paraprake, në vend të prokurorit, i cili duhet të lëshojë një vendim të arsyetuar nëse refuzon kërkesën. Ngjashëm, në mënyrë që të bëhet e mundur që përfitimet nga një gjykim i shkurtuar janë në dispozicion të të pandehurit edhe pasi ai të kërkojë mbledhjen e provave shtesë, është e mundur që të kërkohet një gjykim i shkurtuar “i zakonshëm” pasi kërkesa për një gjykim të shkurtuar “me kusht” të jetë refuzuar. Për më tepër, gjyqtari i seancës paraprake ushtron funksione gjyqësore dhe prokuroriale. Ai ka të drejtë të kërkojë *proprio motu* mbledhjen e provave shtesë (neni 441 (5) i KPP -së italiane). Në mënyrë të ngjashme, pas një numri vendimesh të nxjerra nga Gjykata Italiane e Kasacionit, nëse gjykata e apelit kërkon të kthejë pafajësinë e dhënë në proceset me gjykim të shkurtuar, ata duhet së pari të shqyrtojnë personalisht ata dëshmitarë, deklaratat me shkrim të të cilëve u konsideruan të rëndësishme gjatë gjyqimit në shkallë të parë dhe jo të mjaftohen vetëm me deklaratat e tyre me shkrim (Gjykata e Kasacionit Italian, Vendimi Plenar nr. 14800, 2 Prill 2018). Në gjykimin e saj të fundit në çështjen Di Martino dhe Molinari kundër Italisë (nr. 15931/15 dhe 16459/15, 25 Mars 2021), Gjykata duket se ka vënë theksin në ekzistencën e masave të tilla mbrojtëse në kuadrin e proceseve të gjyqimit të shkurtuar.

Një tipar i sistemit të drejtësisë penale italiane është ai i kompetencës së avokatit mbrojtës

për të mbledhur prova gjatë fazës së hetimit të një çështjeje. Kështu, sipas neneve 391-bis deri në 391-vendimet, e KPP italian, avokatët mbrojtës kanë kompetenca të gjera, pothuajse të barabarta me prokurorin, për të kryer një hetim (të ashtuquajturin “*hetim mbrojtës*”) me qëllim sigurimin e provave, që mund t’i përdorin më pas në dobi të klientit të tyre. Kështu avokatët mund të marrin në pyetje dëshmitarët si dhe të dyshuarit e tjerë / personat e bashkë-akuzuar (në prani të avokatëve të tyre), si dhe të hyjnë në vende publike dhe private me qëllim mbledhjen e provave. Informacioni dhe provat e mbledhura nga akte të tilla hetimore përfshihen më pas në dosjen e mbrojtjes që mbahet në zyrën e gjyqtarit të seancës paraprake, dosje në të cilën prokurori gjithashtu ka qasje.

Sic mund të shihet, gjyqtari i seancës paraprake italiane nuk do të ketë para tij vetëm versionin e ngjarjeve të paraqitura nga prokurori, por edhe atë të të pandehurit, i cili pritet të ketë mbledhur prova shfajësuese ose prova që lehtësojnë përgjegjësinë e tij penale dhe për këtë arsye do të jetë në gjendje të arrijë në një vendim më të informuar dhe vërtet më të drejtë.

Asnjë nga këto masa mbrojtëse nuk është në dispozicion të të pandehurve që kërkojnë një gjykim të shkurtuar në Shqipëri, ku roli i gjyqtarit të seancës paraprake, duket se është më shumë për të bërë një rishikim të përciptë të dosjes së çështjes që zakonisht përmban pothuajse ekskluzivisht materiale inkriminuese dhe jo thjesht të regjistrojë përgjigjen e të pandehurit ndaj pyetjes nëse ai kërkon një gjykim të shkurtuar, në vend që të luajë një rol aktiv në procedurë dhe të sigurojë respektimin e të drejtës së të pandehurit për një gjykim të drejtë. Në mënyrë të ngjashme, roli i avokatit mbrojtës në Shqipëri është veçanërisht i kufizuar pasi ai thjesht mund t’i drejtojë prokurorit kërkesat për mbledhjen e provave shtesë, kërkesa që zakonisht refuzohen në mënyrë të nënkuptuar.

Sugjerohet që, veçanërisht para dy gjykatave të larta shqiptare, avokatët mbrojtës duhet të paraqesin një krahasim midis dy modeleve të gjykimeve të shkurtuara të miratuara në Itali dhe Shqipëri, si dhe dallime të tjera strukturore midis dy sistemeve juridike që janë të rëndësishme për procedurat e heqjes dorë nga gjykimi (siç është roli dhe kompetenca e avokatit mbrojtës) dhe duhet t’i bëjnë thirrje këtyre dy gjykatave të vlerësojnë në mënyrë kritike nëse modalitetet e zbatimit të procesit të gjykimit të shkurtuar në Shqipëri arrijnë një ekuilibër të drejtë midis nevojës për të siguruar administrim të shpejtë të drejtësisë nga njëra anë dhe nevojës për të respektuar të drejtën e të pandehurit për një gjykim të drejtë nga ana tjetër.

3. Argumentet bazuar në qasjen kufizuese ndaj heqjes dorë nga gjykimi, të miratuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Çdo strategji e bazuar në proces gjyqësor do të duhet të trajtojë herët a vonë faktin që qasja e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata) ndaj heqjes dorë nga gjykimet dhe në veçanti ndaj procedurës së gjykimit të shkurtuar është mjaft akomoduese. Kështu, Gjykata ka vendosur që Neni 6 i Konventës nuk e përjashton një të pandehur të heqë dorë nga disa nga të drejtat e tij procedurale, për sa kohë heqja dorë është vendosur në mënyrë të qartë, nuk bie ndesh me një interes të rëndësishëm publik dhe shoqërohet me masa mbrojtëse minimale konform me rëndësinë e saj (*Hermi kundër Italisë* [DHM], nr. 18114/02, 18 tetor 2006, § 73). Në bazë të këtyre tre elementeve, Gjykata ka miratuar modelin e gjykimit të shkurtuar, në çështjen *Cani kundër Shqipërisë, Kniatowska kundër Italisë* (dhjetor) (nr. 52868/99, 30 nëntor 2000) dhe në një numër çështjesh të tjera.

Sidoqoftë, më shumë rëndësi ka fakti se Gjykata duket se ka miratuar aplikimin e

heqjes dorë nga gjykimi dhe e ka gjetur atë në përputhje me Nenin 6 në rastin e një çështjeje e cila duket se përbën një rast studimor të negociatës së detyruar, në tekstet shkollore të drejtësisë. Kështu në çështjen *Natsvlisbivi dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë* (nr. 9043/05, 29 Prill 2014)¹⁸, dy aplikantët zotëronin aksione në një kompani publike ku aplikanti i parë ishte gjithashtu drejtor menaxhues. Ai u akuzua për disa shkelje të ligjit të kompanisë dhe u dërgua në paraburgim. Me iniciativën e tij, u arrit një marrëveshje midis avokatëve të tij mbrojtës dhe prokurorisë, sipas së cilës i pandehuri, edhe pse konfirmonte pafajësinë e tij, nuk do të kundërshtonte akuzat dhe do të rimbursonte shtetin për humbjet e pësuar (më herët, ai dhe gruaja e tij i kishin transferuar shtetit pjesën e tyre të aksioneve në kompaninë publike, pa pagesë) si dhe i kishin bërë një pagesë tjetër shtetit si tarifë për përfundimin e marrëveshjes. Nga ana e tij, prokurori mori përsipër t'i kërkojë gjykatës së çështjes ta shpallë atë fajtor pa shqyrtuar themelin e çështjes dhe të vendosë një gjobë, në vend të dënimit me burg. Gjykata, pasi dëgjoi të pandehurin dhe mori parasysh se ai ende ruante pafajësinë e tij, e shpalli fajtor sipas akuzës. Duke vënë në dukje se ai kishte pranuar kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe se i kishte kthyer vullnetarisht shtetit paratë e përvetësuar. Gjykata, më pas, e dënoi me pagesën e një gjobe. Në kohën kur u dha vendimi nuk kishte mundësi ankimi dhe një mundësi e tillë u paraqit më vonë.

Aplikanti i parë paraqiti një kërkesë në Gjykatë, duke argumentuar se, në rastin e tij, e drejta për një gjykim të drejtë ishte shkelur për shkak të mënyrës së zbatimit të procedurës së marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Dhe ai nuk ishte i vetmi që ngrinte dyshime për mënyrën e zbatimit të kësaj

procedure në Gjeorgji; organe të ndryshme të Këshillit të Evropës si Komisioneri për të Drejtat e Njeriut dhe Asambleja Parlamentare e Këshillit kishin shprehur shqetësimet e tyre për modalitetet e zbatimit të procedurës së marrëveshjeve të pranimit të fajësisë. Më konkretisht, ata ishin kritikë ndaj kompetencave shumë të mëdha diskrecionale të prokurorit, mbikëqyrjes së kufizuar gjyqësore të marrëveshjeve të tilla dhe mbivlerësimit nga ana e gjykatave të provave të paraqitura nga prokurori, si dhe ndaj karakterit taksativ të gjobave të vendosura pas marrëveshjeve të tilla, fondi i të cilave më pas devijojë për të mbuluar nevoja të tjera si pagesa e pensioneve. Ata gjithashtu vunë në dukje se për shkak të shkallës jashtëzakonisht të lartë të dënimeve, kishte shumë mundësi që të pandehurit të ndiheshin të detyruar të zgjidhnin një marrëveshje pranimiti fajësie në mënyrë që të nxirrnin më të mirën nga një situatë e keqe. Ngjashëm, në vend që të përpiqen të sigurojnë që klientët e tyre të përfitojnë nga një gjykim i drejtë, avokatët shpesh i këshillonin ata që të bënin sa më shpejt një marrëveshje me prokurorin. Për më tepër, sipas një raportit të Transparency International dhe në bazë të statistikave zyrtare, gjykatat pothuajse gjithmonë miratojnë marrëveshjet e pranimit të fajësisë-, me vetëm 8 nga 8,770 kërkesa për miratimin e marrëveshjeve të rrëzuara në vitin 2008, një përqindje kjo prej më pak se 0.1%. Në mënyrë të ngjashme dhe jashtëzakonisht e ulët ishte dhe shkalla e pafajësisë, që varion nga 0,7% në 2005 në 0,1% në 2007-2009, gjë që bëri Transparency International të vërejë se, me norma të tilla dënimi, prokurorët mund të imponojnë lehtësisht kushtet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, duke e ditur se në qoftë se i pandehuri nuk pranon, do t'i duhet t'i nënshtrohet një procesi të gjatë gjyqësor që pothuajse me siguri do të çojë në dënimin e tij (*Natsvlisbivi dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*, op. cit., §§ 55-61). Sikur të mos mjaftonte kjo, para se të pranonte marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë,

18 Pjesët kryesore të aktgjykimit janë në dispozicion në gjuhën shqipe në faqen e internetit të Gjykatës.

aplikanti u mbajt për një periudhë kohe në paraburgim, në të njëjtën qeli me kushte të këqija, me personin që e kishte rrëmbyer dhe keqtrajtuar në të kaluarën.

Sidoqoftë, asnjë nga elementët e mësipërm në vetvete ose bashkërisht, sipas mendimit të Gjykatës, nuk mund të përbëjë shkelje të nenit 6. Kështu Gjykata u jep peshë konsideratave të mëposhtme.

Së pari, fakti që ishte kërkuesi ai që kërkoi marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe shprehu gatishmërinë për të rikthyer fondet që dyshohej se i kishte përvetësuar shtetit.

Së dyti, atij iu dha qasje e plotë në dosjen e çështjes.

Së treti, gjatë marrëveshjes për pranimin e fajësisë ai u ndihmua nga dy avokatë privatë.

Së katërti, ai u pyet në mënyrë të përsëritur, si nga prokurori, ashtu edhe nga gjykata, nëse ai bëri marrëveshjen e pranimit të fajësisë me vullnetin e tij të lirë dhe nëse ai i kuptonte plotësisht kushtet e saj, pyetje të cilave ai gjithmonë i përgjigjej në mënyrë pozitive.

Së pesti, një procesverbal me shkrim i marrëveshjes u hartua dhe iu paraqit gjykatës për shqyrtim.

Së gjashti, gjykata kishte kompetencën e refuzimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë nëse e konsideronte të pabarabartë ose mund të ulte dënimin e rekomanduar nga prokurori,

Së shtati, gjykata shqyrtoi dhe miratoi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në një seancë publike. Elementet e mësipërme e bënë Gjykatën të konstatojë se aplikanti kishte rënë dakord lirisht të hiqte dorë nga drejta e tij për apelim duke bërë marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe se për më tepër vendimi i tij për ta bërë këtë ishte “padyshim

i ndërgjegjshëm dhe vullnetar”, kjo u ndoq nga një nivel minimal masash mbrojtëse dhe nuk binte ndesh me asnjë interes publik (*Natsvlisbvoli dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*, op. cit., §§ 93-97, 97).

Siç mund të shihet, sfidat me të cilat përballen aplikantët në *Natsvlisbvoli dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë* ishin të ngjashme me ato me të cilat po përballen të pandehurit në Shqipëri. Të përballur me një dënim pothuaj të sigurt dhe pa mundur të paraqesin një mbrojtje efektive, nuk ka nevojë që autoritetet të bëjnë ndonjë lloj presioni ndaj të pandehurve për të kërkuar ose për të rënë dakord për heqjen dorë nga gjykimi, pasi vetë të pandehurit do ta japin “vullnetarisht” pëlqimin për një heqje dorë nga gjykimi në mënyrë që të paktën të marrin disa përfitime.

Ndaj, më pas lind pyetja: nëse Gjykata ka miratuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, qoftë në parim në një numër çështjesh kundër Italisë dhe Shqipërisë, por dhe në çështje me fakte aq ekstreme sa ato të *Natsvlisbvoli dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*, sa shanse kanë të ketë sukses me kundërshtimet e tij para gjykatave vendase, kur ato mund ta rrëzojnë apelimin/kundërshtimin, thjesht duke cituar vendimet e Gjykatës?

Përgjigja për këtë pyetje është e trefishtë.

Së pari, dhe në lidhje me Shqipërinë, kujtojmë se dallimet midis dy procedurave të gjyqësorisë të shkurtuar janë të rëndësishme. Objektivi i proceseve gjyqësore para gjykatave shqiptare nuk duhet të jetë sfidimi i vetë institutit të gjyqësorisë të shkurtuar, por përkundrazi nxjerrja në pah e këtyre dallimeve dhe demonstrimi i ndikimit të tyre në të drejtat procedurale penale të të pandehurit dhe sugjerimi i përmirësimeve në përputhje me modelin italian, me shpresën që një nga dy gjykatat kryesore do t'i adresojë këto shqetësime. Kujtojmë se edhe pse Gjykata miratoi modelin e gjyqësorisë të shkurtuar

shqiptar në *Cani kundër Shqipërisë*, ajo e bëri këtë vetëm në parim dhe e nënshtroi kërkesën e tij për shqyrtim të imët, duke vlerësuar se dështimi i autoriteteve për të siguruar pjesëmarrjen në gjykatë të aplikantit ishte në shkelje të nenit 6 dhe duke thënë se i pandehuri duhet të dëgjohet efektivisht, gjithmonë. Parashtrohet se Gjykata do të ishte pranuese ndaj argumenteve që ngrenë shqetësime në lidhje me mangësi të ngjashme strukturore, të tilla si pamundësia e paraqitjes së provave shfajësuese, qoftë drejt për së drejti ose duke ia kërkuar prokurorit, në kuadrin e procedurave të gjykimit të shkurtuar.

Së dyti, gjykatat e tjera ndërkombëtare kanë miratuar një qasje më kritike ndaj marrëveshjeve të pranimit të fajësisë. Edhe pse një çështje jo e krahasueshme drejtpërdrejt, vlen të përmendet; Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) hodhi poshtë një marrëveshje për pranimin e fajësisë nga një shtetas australian i arrestuar nga forcat amerikane në Afganistan me akuza për terrorizëm i cili u mbajt në kampin e paraburgimit në Gjirin Guantanamo në Kubë. Sipas kushteve të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, aplikanti u deklarua fajtor në këmbim të një dënimi të reduktuar, një pjesë e së cilës do të kryhej në Australi. Pas kthimit në Australi, ai apeloj pjesën e dënimit që sipas kushteve të marrëveshjes për pranimin e fajësisë ai duhej ta kryente në Australi, duke argumentuar se për shkak të shkeljeve të shumta të dukshme procedurale në marrëveshjen e pranimit të fajësisë, si dhe keqtrajtimit të tij dhe kushtet e paraburgimit në Gjirin Guantanamo, marrëveshja e tij ishte efektivisht e detyruar. Komiteti u pajtua, duke vënë në dukje se: “... për t’i shpëtuar shkeljeve të cilave iu nënshtrova, autori nuk kishte zgjidhje tjetër përveçse të pranonte kushtet e marrëveshjes së pranimit të fajësisë që iu vendosën”.¹⁹ Kjo çështje, si dhe çështje të

ngjashme të gjykuara nga gjykatat supreme kombëtare, mund përdoren si reference për të demonstruar se këndvështrimi i Gjykatës në *Natsvlisbvilii dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë* nuk ndahet nga ai i gjykatave të tjera ndërkombëtare ose kombëtare; në të vërtetë, një nga gjyqtarët e Gjykatës dha një mendim pjesërisht kundërshtues, në të cilin ai argumentoi se duke pasur parasysh dënimin pothuaj të sigurtë të aplikantit, për shkak të shkallës së pafajësive prej 0,4% në atë kohë, kërkuesi nuk mund të pritej të zgjidhte gjykimin e zakonshëm (po aty, § 4 i opinionit pjesërisht kundërshtues nga gjyqtari Gyulumyan).

Së treti, çështja e litigimit strategjik duhet të zgjidhet me kujdes në mënyrë që të sigurohet që jo vetëm shqetësimet për rezultatin e gjyqit, por edhe konsideratat e tjera shoqërore ose financiare të kenë ndikim në kërkesën e të pandehurit për të kërkuar heqjen dorë nga gjykimi. Siç është vërejtur në një artikull shkencor të kohëve të fundit për heqjen dorë nga gjykimi mbi motivimin e të pandehurve në pranimin e heqjes dorë nga gjykimi,²⁰ Gjykata ka adoptuar një qasje të ndryshme nga ajo e *Natsvlisbvilii dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*, në një çështje të mëparshme *Deweer kundër Belgjikës* (nr. 6903/75, 27 shkurt 1980). Në këtë çështje, aplikanti kishte një dyqan mishi dhe akuzohej për shitjen e produkteve të tij me një çmim më të lartë se ai i lejuar me ligj. Si rezultat, atij iu paraqitën dy opsione, të deklarohej fajtor për akuzën dhe të paguante një gjobë ose të niste procesin penal, ndërkohë që dyqani i tij do rrinte i mbyllur. Kuptueshëm, ai zgjodhi opsionin e parë. Para Gjykatës ai argumentoi se arsyeja pse ai u deklarua fajtor ishte frika

Nëntor 2015, CCPR/C/115/D/2005/2010, paragrafi 4.9.

20 Rebecca K. Helm, Heqje e Kufizuar e të Drejtave të Gjykimit? Nxitjet për të shpallur fajtor dhe të drejtën për një gjykim të drejtë, *Revista e Drejtësisë dhe Shoqërisë*, Vëll. 46, Çështja 3, faqe 423 - 447, 2019

19 KDNJ të OKB -së, Komunikimi No. 2005/2010, Hicks kundër Australisë,, 5

se në rast se ai kundërshtonte akuzën para gjykatës do i privoheshin mjetet e tij të jetesës. Gjykata u pajtua, duke vënë në dukje se ndërsa Konventa përjashton heqjen dorë nga të drejtat, në rastin konkret motivimi kryesor prapa vendimit të aplikantit për të rënë dakord për këtë gjë ishte humbja ekonomike që do kishte nga mbyllja, qoftë edhe e përkohshme e biznesit të tij (po aty., § 51 (b)). Për më tepër, duket se ai kishte shanse për të dalë i pafajshëm; siç vërehet edhe nga Gjykata, në shumë raste të ngjashme të pandehurit janë shpallur të pafajshëm (po aty). Me fjalë të tjera, aplikanti ra dakord për pranimin e marrëveshjes së fajësisë, jo për shkak se e konsideroi të sigurtë dënimi i tij dhe donte të minimizonte humbjet, por përkundrazi, sepse kishte shanse të mira për t'u shpallur i pafajshëm pas një gjykimi gjithsesi të gjatë, me dyqanin e tij të mbyllur dhe pa pasur mundësinë për të kërkuar kompensim nga shteti për humbjet e tij financiare (po aty., § 52). Gjykata gjithashtu komentoi mbi mungesën e proporcionalitetit të “incentivave” ofruar aplikuesit: nga njëra anë, duke rënë dakord të paguajë gjobën aplikanti humbte 10,000 Franga belge (rreth 250 Euro me çmimet e sotme - kujtojmë se çështja daton në 1980), ndërsa duke e kundërshtuar akuzën do t'i kushtonte patjetër shumë më tepër (po aty., § 51 (b)). Gjykata, me një arsyetim veçanërisht interesant, përmbysi argumentin e Qeverisë me përfundimin se gjoba ishte mjaft modeste në natyrë (dhe me të vërtetë, tarifa minimale ishte 3000 Franga belge), duke vënë në dukje se ishte pikërisht “pabarazia flagrante” mes gjobës së ulët në njërin anë dhe pasojave të rënda financiare me të cilat do të përballej aplikanti nëse dyqani i tij do mbyllej që shpjegon vendimin e tij për të pranuar marrëveshjen e pranimit të fajësisë, ku gjykata u shpreh se ky ndryshim “...e bëri presionin kaq të madh sa nuk duhet të çuditemi që aplikanti iu dorëzua atij” (po aty., § 51 (b)). Për pasojë, heqja dorë e të drejtës së aplikantit për gjykim të drejtë nuk është e pastër por e detyruar, në shkellje të nenit 6 të Konventës.

Çuditërisht, çështja *Deweer kundër Belgjikës* nuk citohet nga Gjykata në gjykimin e *Natsvlisbvili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*.

Parashtrohet se qasja e Gjykatës në *Deweer kundër Belgjikës* është qasja e saktë; megjithatë duke patur parasysh që gjykimi i *Natsvlisbvili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë* konsiderohet të jetë autoritare në çështjet e marrëveshjeve të pranimit të fajësisë, është e rëndësishme të qartësohen se cilat janë ato aspekte të *Deweer* që mund të përshtaten në qasjen e Gjykatës në çështjen *Natsvlisbvili*. Është e qartë p.sh. se, ndryshe nga ajo që ndodhi në *Deweer*, Gjykata pas çështjes *Natsvlisbvili* nuk merr parasysh normat e përgjithshme të lirimit / dënimit, pasi nuk i konsideron ato si faktorë që ndikojnë vendimmarrjen e të pandehuri për të kërkuar ose pranuar heqjen dorë nga gjykimi. Në të njëjtën kohë, megjithatë, në *Natsvlisbvili*, aplikanti (kuptueshëm) nuk u ankua se vendimi i tij për të pranuar marrëveshjen e pranimit të fajësisë mori shkas nga konsiderata të tjera përveç rezultatit të gjykimin, pavarësisht se sa i paracaktuar mund të ishte. Ankesa e aplikantit para Gjykatës në çështjen *Deweer* nuk ishte se ai veproi ashtu siç veproi nga shqetësimi për rezultatit e gjykimin të tij (në të vërtetë, faktet tregonin se ai kishte shanse të mira për t'u deklaruar i pafajshëm), por nga shqetësimi i ndikimit që do të kishte në jetën e tij profesionale mospranimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë.²¹

Sipas zonjës Helm, ka tre elementë që duhet të shqyrtohen në mënyrë kumulative në mënyrë që të konstatohet nëse heqja dorë nga gjykimi është e vullnetshme. Së pari, nëse incentivi i ofruar e bën të paarsyeshme pritshmërinë që i pandehuri të refuzojë heqjen dorë nga gjykimi. Së dyti, nëse incentivi nuk varet nga rezultati i gjykimin dhe së treti nëse ishte incentivi që e bëri aplikantin të pranonte fajësinë, pasi nëse

21 Po aty, faqja 432

i pandehuri ra dakord me heqjen dorë nga gjykimi jo për shkak të incentivit, por për arsye të tjera, nuk ishte incentivi që ndikoi në zgjedhjen e të pandehurit për të pranuar heqjen dorë nga gjykimi.²²

Për t'i përkthyer sa u tha më sipër në praktikë, dhe për të parandaluar aplikimin automatik të *Natsvlisvili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë* nga ana e gjykatave vendase, në litigimet strategjike, është e rëndësishme të zgjidhet një çështje ku, përveç sanksionit penal, vendosen edhe sanksionet e tjera që kanë ndikim në mundësinë e të pandehurit për të fituar jetesën e tij. Me fjalë të tjera, duhet

të zgjidhet një çështje ku pasojat që do të sillte në jetën e të pandehurit moszgjedhja e heqjes dorë nga gjykimi (p.sh. pezullimi i patentës së një shoferi profesionist për një periudhë më të gjatë kohe) tejkalojnë qartë përfitimet nga procesi penal (në formën e uljes së dënimit ose përfundimit të shpejtë të procedurës). Atëherë mund të argumentohet se i pandehuri zgjodhi heqjen dorë nga gjykimi jo për shkak të përfitimeve (reale ose të perceptuara) në procedimin kundër tij, por më tepër për të minimizuar dëmin kolateral që do të kishte një gjyq të zakonshëm në jetën e tij/saj personale dhe familjare, një linjë argumentimi që nuk u ngrit nga aplikanti në *Natsvlisvili dhe Togonidze kundër Gjeorgjisë*.

22 Po aty, faqja 434

PJESA C:

REKOMANDIME DREJT SIGURIMIT TË NJË MARRËVESHJEJE MË TË MIRË PËR TË GJITHË

1. Mbledhja dhe shpërndarja e statistikave më të plota mbi heqjet dorë nga gjykimi

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat u përball qendra Res Publica gjatë kryerjes së studimit mbi heqjen dorë nga gjykimet në Shqipëri ishte mungesa e statistikave cilësisore. Edhe pse grumbullimi i informacionit nga burime të ndryshme mund të japë një pasqyrë pak a shumë të saktë se sa shpesh aplikohen heqjet dorë nga gjykimi dhe cilat janë rezultatet e tyre, kjo nuk mund të zëvendësojë statistikat zyrtare. Prandaj administrata e gjykatave duhet të mbledhë statistika të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- gjykata,
- mosha, gjinia, kombësia ose origjina etnike e të pandehurit
- lloji i krimit,
- lloji i procedurës (p.sh. gjykimi i

shkurtuar / gjykimi sipas marrëveshjes / gjykimi i zakonshëm)

- kohëzgjatja e procedimit sipas llojit të procedurës
- dënimi mesatar sipas llojit të krimit për procedurë dhe sipas moshës, kombësisë ose origjinës etnike të të pandehurit
- përqindja e rasteve kur gjykatat refuzojnë të miratojnë një gjykim me marrëveshje / transferojnë një çështje nga procedura e gjykimit të shkurtuar në procedurën e gjykimit të zakonshëm, si dhe arsyet për këtë.
- përqindja e çështjeve ku personat që e kishin pranuar fajësinë përfundimisht u shpallën të pafajshëm, për të vlerësuar dhe adresuar risqet e dështimit të drejtësisë.

Në mënyrë të ngjashme, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të mbledhë statistika sipas:

- zyrës së prokurorit
- moshës, gjinisë, kombësisë ose origjinës etnike të të pandehurit
- llojit të krimit
- llojit të procedurës së ndjekur pas përfundimit të hetimit paraprak (gjykim me marrëveshje / gjykim të shkurtuar / gjykim të zakonshëm)
- kohëzgjatjes së procedimit sipas llojit të procedurës
- dënimit mesatar të propozuar nga prokurori dhe të lënë në fuqi nga gjykata në gjykimet me marrëveshje sipas moshës, kombësisë ose origjinës etnike të të pandehurit

Statistika të tilla jo vetëm do të lejonin hartuesit e politikave dhe studiuesit të identifikonin tendencat e reja në zhvillim, por gjithashtu mund të shërbenin si mjete për vlerësimin e performancës së gjyqtarëve / prokurorëve. Kështu, një prokuror i cili zgjidh shumicën e çështjeve të tij me anë të gjykimeve me marrëveshje apo një gjyqtar i cili pothuajse gjithmonë i miraton këto marrëveshje duhet t'i nënshtrohet vlerësimit të performancës.

Praktika të mira

Në Shtetet e Bashkuara, Komisioni i Dënimit mbledh të dhëna nga gjykatat për çdo krim dhe kundërvajtje të klasit A. Brenda 30 ditëve nga marrja e vendimeve në çështjet penale, gjykatat i paraqesin një raport Komisionit, i cili përmban akt akuzën, marrëveshjen e pranimit të fajësisë, raportin e prezencës, gjykimin dhe deklaratën me shkrim të arsyeve. Një sërë të dhënash nxirren nga këto dokumente dhe analizohen për t'u sjellë në vëmendjen e politikëbërësve dhe komunitetit të drejtësisë penale federale. Ata mbledhin dhe analizojnë numrin e çështjeve të trajtuara nga gjykatat penale çdo vit, prejardhjen demografike të njerëzve të dënuar dhe llojin e veprave penale të trajtuara. Më specifikisht, mblidhen të dhëna për përqindjen e çështjeve ku të pandehurit pranojnë fajin ose kryejnë një gjykim të plotë dhe mbi përqindjen e pranimit të fajësisë sipas llojit të krimeve.

Në Mbretërinë e Bashkuar, Ministria e Drejtësisë mbledh dhe publikon statistika tremujore mbi ngarkesën dhe afatet në Gjykatat e Magjistraturës dhe Gjykatat e Kurorës. Të dhënat gjithashtu mblidhen mbi normat e pranimit të fajësisë që lejon krahasimin e kohëzgjatjes mesatare midis çështjeve kur të pandehurit pranian fajësinë ose jo. Gjithashtu, mblidhen të dhëna për të krahasuar normat e pranimit të fajësisë midis grupeve të ndryshme demografike (burra/gra, të bardhë, me ngjyrë, Aziatikë dhe të tjerë), për të përcaktuar në cilën fazë të procesit u kërkuan dhe miratuan pranimet e fajësisë dhe kohëzgjatjen mesatare të dënimit me burgim për personat që pranian fajin dhe ata që nuk e pranian.

Në Finlandë, ku heqja dorë nga gjykimi bëhet në gjyq të hapur, në gjykimin e rradhës tregohet çfarë dënimi do të kishte marrë i pandehuri nëse dënimi do të ishte dhënë pas një gjykimi të plotë dhe jo si rezultat i heqjes dorë nga gjykimi.

2. Bërja më transparente e gjykimeve me marrëveshje

Sipas studimeve të Res Publica, ndërsa dënimet e kërkuara nga prokurorët në kontekstin e gjykimeve me marrëveshje janë zakonisht më të ulëta se ato të dhëna nga gjykatat në çështje të ngjashme, nuk ndodh kështu për një numër të kufizuar veprash (p.sh. kundërshtimi i një punonjësi policie) ku dënimet e kërkuara nga prokurorët (dhe zakonisht të miratuara nga gjykatat) janë dukshëm më të larta se ato të vendosura nga gjykatat në procedurat e zakonshme gjyqësore. Asnjë arsye nuk parashtrohet për këtë mospërputhje, e cila me sa duket është për arsye institucionale, përkatësisht marrëdhënies së ngushtë midis policisë dhe prokurorisë, gjë që e bën këtë të fundit ta konsiderojë çdo veprë kundër policisë si veçanërisht të rëndë.

Edhe pse Res Publica nuk advokon domosdoshmërisht për zgjidhje sipas modelit italian të marrëveshjes për pranimin e fajësisë (*applicazione della pena su richiesta delle parti*, e njohur në zhargon si *patteggiamento sulla pena* ose thjesht *patteggiamento*) në të cilën ulja e dënimit është e kufizuar në një të tretën (neni

444 i KPP-së italiane), e gjen problematike diskrecionin e pakufizuar të prokurorit për të vendosur se cilat krime meritojnë ulje të konsiderueshme të dënimit dhe cilat jo. Për më tepër, një diskrecion i tillë krijon shqetësim nëse vendimi i prokurorisë për uljen e dënimit të ofruar, mund të ndikohet nga konsiderata të tjera, të tilla si identiteti i të pandehurit ose perceptimi i prokurorit për fajësinë e tij.

Për këtë qëllim, Res Publica rekomandon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë të miratojë udhëzime që përcaktojnë gamën e uljeve të lejueshme të dënimit, si dhe të sigurojë që largimi nga pragjet si ato të poshtme ashtu edhe të sipërme sa më shumë që të jetë i mundur, me kusht që prokurori të japë arsye bindëse (për t'u rishikuar nga gjykata) se pse është i nevojshëm një largim i tillë në rastin konkret. Është po aq e rëndësishme që udhëzimet të tërheqin vëmendjen e prokurorëve në nevojën e domosdoshme për të mos bërë asnjë ofertë për gjykim me marrëveshje para se të grumbullohen prova të mjaftueshme që dëshmojnë *prima facie* fajësinë e të pandehurit. Për më tepër, udhëzimet duhet të tërheqin vëmendjen e prokurorëve për nevojën për t'u përgjigjur kërkesave të arsyetuara për mbledhjen e provave shtesë.

Praktika të mira

Në Slloveni, Udhëzimet e Përgjithshme të Zyrës së Prokurorit Publik Suprem në lidhje me negocimin dhe propozimin e sanksioneve në çështjet e pranimit të marrëveshjeve të fajësisë, u publikuan në vitin 2012. Ato përshkruajnë premisën bazë për propozimin e sanksioneve penale. P.sh., ato thonë se pikënisja për masën e propozuar të sanksionit penal duhet të përputhet në masë të madhe me sanksionet e vendosura nga gjykatat dhe rrethanat objektive dhe subjektive të veprës penale; që dënimi i propozuar nuk duhet të jetë më pak se dy të tretat e dënimit të dhënë nga gjykata në një rast të ngjashëm.

Në Francë, Ministria e Drejtësisë publikoi një Qarkore mbi procedurën e njohjes së fajësisë, në 2004. Ajo parashikon që kjo procedurë duhet të zbatohet vetëm për çështje që janë gati për gjykim, që do të thotë çështje që mund të çohen menjëherë në gjykatë pa nevojën e hetimeve të mëtejshme; dhe se vepra penale duhet të jetë relativisht e thjeshtë, të lejojë një vlerësim të saktë të gravitetit të saj pa qenë nevoja për debate të gjata. Ajo gjithashtu kërkon një parashikueshmëri të sanksionit që do të vendoste gjykata penale, në mënyrë që i pandehuri të dijë të vlerësojë përshtatshmërinë e penalteteve të ofruara nga prokurori.

3. Përfitimi nga praktikat e mira ekzistuese dhe marrja e masave për krijimin e një fushe më të barabartë loje midis të pandehurve/avokatëve të tyre dhe prokurorëve/gjyqtarëve

Për qendrën Res Publica është veçanërisht problematike mungesa e madhe e ekuilibrit të pushtetit mes aktorëve të ndryshëm, problem që prek jo vetëm procedimet që zhvillohen nën mekanizmat e ndryshëm të heqjes dorë nga gjykimi, por edhe procedimet gjyqësore të zakonshme në përgjithësi. Si rezultat, nevojitet një qasje më gjithëpërfshirëse, një qasje që kërkon një ndryshim thelbësor të Kodit të Procedurës Penale.

Për fat të mirë, ligjvënësi nuk duhet të kërkojë shumë për praktikat të mira të mundshme. Në dritën e elementeve të shumtë që janë huazuar drejtpërdrejt nga sistemi italian i drejtësisë penale, është e rëndësishme të ndërmerret një studim i thelluar krahasues i të dy sistemeve me qëllim identifikimin e elementeve të mëtejshëm që mund të futen në rendin juridik shqiptar. Në këtë aspekt, Res Publica e konsideron thelbësore që fushëveprimi i kompetencave të avokatit mbrojtës të zgjerohet, në mënyrë që ai mund të marrë pjesë më aktive në hetimet penale, të veprojë si kundërpeshë ndaj prokurorit dhe të sigurojë që prova shfajësuese ose lehtësuese të jenë mbledhur dhe paraqitur në gjykatë.

* * *

Res Publica
Tetor 2021

www.respublica.org.al

www.pubbleaks.al

www.fairtrials.org